Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. **Nr. 9(17). Shtator 2007** Çmimi: **50** lekë, **20** dinarë

Kur do të shkruhet historia e Dibrës?

Nga SHAQIR SKARRA

Ende mbetet e virgjër treva e Dibrës për studiuesit dhe historianët, për arkeologët dhe gjuhëtarët, për mbledhësit e folklorit dhe etnografët. Ende historia e Dibrës nuk është shkruar. Vitet e fundit janë botuar mjaft studime me bazë fisi dhe fshatrash. Është shkruar për figura patriotësh, por dhe janë vlerësuar figura që nuk i lidh asgjë me patriotizmin dhe atdhedashurinë. Është botuar kanuni, që në fakt Dibra nuk ka pasur një të tillë, por që ka njohur kanunin e Skënderbeut. Janë bërë dhe disa studime spontane arkeologjike, janë botuar dhe studime për rrugët e Dibrës.

(Lexoni në faqen 3)

Sukses i teatrit në Dibër

Përfundoi Festivali i gjashtë "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"



SPECIALE NË FAQET 5-6-7-8

Konkretizohet Financimi Hollandez për Qarkun e Dibrës

4.6 milionë Euro për gjashtë bashki dhe Komuna

FAQE 2

Prezantohet libri "Rruga e Arbërit"

FAQE 12

"Ne, dibranët, duhet të bëjmë më shumë për Dibrën"

PROFIL - FATMIR KURTI
FAQE 9

Profesor Ibrahim Egriu, njeriu që e ngriti lart emrin e Dibrës dhe në vendet skandinave

FAQE 9

Naim Plaku dhe "Këngët e Korabit"

Nga DR. FEJZULLA GJABRI
FAQE 10

"Dibrës i ka pikur vathi, por jo veshi!"

NGA GAZMEND KËRKUTI
FAQE 12

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Guri i poshterkës

Nga NAIM PLAKU

Kikja, cuca e mbrame e Ute Llozit, sapo kishte shkelë në senen e ogurit, ishte çelë e zbukuruar dhe vishej pak më ndryshe, kur merrte tufën e shqerrave dhe i podiste mejave të Kollovozit...

Faqe 11

EMIGRACION

MA RINOVE SHPIRTIN OR MANUKA I SELISHTËS

Nga **ABDURRAHIM ASHIKU**
Athinë

Emata disa here derisa e preva të publikoj në gazetë telefonin familjar dhe celularin vetjak. Ndjej se kam bërë mire. E them këtë sepse tashmë e ndjej se e jetoj jetën më aktivisht. E them këtë sepse tashmë e ndjej veten jo vetëm në Athinë ku kam nëntë vjet i ngujuar, por edhe në treva të tjera greke. E them këtë sepse tani e ndjej veten më pranë vendit tim, e ndjej veten në Shqipëri, në dheun ku linda dhe u rrita, atje ku gurët e gjëmbat më gjakosnin këmbët e zbathura, majmaleve të lartë duke kapur retë…

Një telefonatë nga Mitilini më ngjiti në bjeshkët e Hynoskës. Më ngjit javë për javë sa here më merr Beni i Ilnicës…

Një telefonatë nga Korfuzi më zbriti në luginën e Drinit. Më zbret sa herë më merr në telefon Ibrahimi nga Muhurri…

Për ta kam shkruajtur...

Sot më mori në telefon një burrë nga Manukajt e Selishtës, Guri e quajnë. Është mësues. Ka mbaruar për anglisht dhe gjermanisht....

(Lexoni në faqen 5)

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com. www.dibra.org

Konkretizohet Financimi Hollandez për Qarkun e Dibrës

4.6 milionë Euro për gjashtë bashki dhe Komuna

Më datë 19 Shtator, në sallën e Qendrës së Edukimit dhe Komunikimit në Peshkopi, u mbajt ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve të para mes bashkive fituese të raundit të parë dhe Qarkut të Dibrës në kuadër të programit "Forcimi i Qeverisjes Lokale në Dibër", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës dhe SNV (Organizata Hollandeze për zhvillim).

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues nga ambasada Holandeze, SNV- Ballkan, Këshilli i Qarkut Dibër, kryetarët e komunave dhe bashkive, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera në rajon.

Ky program, do të jetë 3 vjeçar dhe ka një fond prej 4.6 milionë Euro dhe do të jetë për të ndihmuar bashkitë dhe komunat, që të zbatojnë planet e tyre strategjike sipas prioriteteve të vëna. Financimi quhet "Fond i Besuar" dhe është i ndarë në 5 raunde. Raundi i parë sapo përfundoi dhe në të fituan bashkitë Peshkopi dhe Klos, si dhe Komunat Lis, Tomin, Melan, Sllovë. Gjithashtu, programi ka dhe komponentin e rritjes së kapaciteteve, i cili po mbështet me studime, ekspertize, trajnime, hartim planesh strategjike për komunat dhe bashkitë.

Takimin e hapi dhe e përshendeti Kryetari i Qarkut të Dibrës, z. Naim Gazidede, i cili, bëri një përmbledhje të aktiviteteve të programit deri në këtë periudhë. Ai falënderoi për punën e mirë të bërë nga skuadra e programit, administrata e këshillit të Qarkut, seriozitetin dhe angazhimin e kryetarëve dhe stafeve të komunave dhe bashkive që aplikuan në raundin e parë, si dhe bashkëpunimin e mirë dhe mbështetjen që ka patur me stafin e SNV në Dibër dhe me drejtuesit e Ambasadës Holandeze. Z. Gazidede bëri një përmbledhje të programit në përgjithësi, me arritjet dhe vështirësitë e ndeshura gjatë kësaj periudhe, si: gjetja e fondeve të bashkëfinancimit nga komunat dhe bashkitë, cilësia e projekteve, ekspertiza e nevojshme, çështje e TVSH, (e cila do të mbulohet nga qeveria qendrore, megjithëse është në rrugë të mbarë, nuk u arrit të përfitohet këtë raund, por do të jetë e mbuluar për raundet e tjera të programit), etj.. Ai, shprehu besimin që ka të stafi i tij, si dhe te bashkitë e komunat e qarkut, që për raundet e tjera do të ketë më shumë fonde, më shumë projekte cilësore të aplikuara, më shumë bashkëpunim mes komunave për projekte të përbashkëta, si dhe një zbatim me cilësi të projekteve nga bashkitë dhe komunat fituese të raundit të parë.

Në emër të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, përshëndeti zv. Ambasadorja Ardi Stoiosbraken. Ajo u fokusua në rolin që ambasada Holandeze, si përfaqësuese e Komunitetit Europian, ka në Shqipëri. Ajo theksoi se ky program ka për qëllim të nxisë mirëqeverisjen në rajonin e Dibrës dhe të ndihmojë në zhvillimin ekonomiko – social, të cilat pjesë e mbështetjes që Komuniteti Europian po jep për Shqipërinë, për të arritur progres në arritjen e standardeve europiane. Ajo vlerësoi angazhimin e aktorëve lokal të programit, si dhe kërkoi që ky angazhim të jetë dhe në raundet e tjera në vazhdim.





Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Bert van Nieuwnhuizen, Drejtori Ekonomik i SNV – Ballkan, vlerësoi progresin që ka bërë Shqipëria në këto dy vjet që ai është në Tiranë, natyrën e bukur që ka Dibra dhe karakterin punëtor që kanë dibranët, gjë e cila tregohet dhe në punën e stafit të SNV në Dibër, i cili është më i madhi në Ballkan. "Nuk mund të kapet gjithçka që sheh syri", thotë një fjalë e urtë holandeze. Kjo do të thotë që secila nga fazat e programit kërkon kohën e saj, burimet financiare të nevojshme dhe njerëzit e duhur", theksoi z. Bert. Ai tërhoqi vëmendjen e kryetarëve fitues për të zbatuar në kohë dhe në cilësi projektet, pasi ata do të jenë pasqyra e programit dhe një fillim i mbarë i tij.

Me shume interes u prit nga të pranishmit prezantimi që menaxheri i Programit Zenulla Mehmeti, bëri për projektet fituese. Ai prezantoi të gjitha të dhënat teknike dhe financiare kryesore për projekt, formën e vlerësimit si dhe vështirësitë që struktura menaxhuese e projektit hasi gjatë raundit të parë dhe bëri sugjerime, të cilat duhen të kihen parasysh për raundet e tjera. Transparenca është një nga vlerat që ka ky program, nënvizoi menaxheri i programit, prandaj po përpiqemi që këtë proces ta bëjmë sa më të kapshëm për të gjithë, me tregues statistikor dhe financiar për çdo projekt.

Më pas, vazhdoi me nënshkrimin e kontratave, ku në emër të kryetareve të njësive fituese përshëndeti kryetari i bashkisë Peshkopi, z. Ilir Krosi, i cili garantoi donatorët dhe të pranishmit, që çdo lekë i marrë do të shkojë sipas projektit dhe puna do të jetë sipas standardeve teknike dhe me cilësi të lartë. "Ashtu siç quhet mbështetja financiare "Fondi i Besuar", ashtu do të punojmë dhe ne, që të mos e humbim këtë besim që ka ambasada, qarku dhe gjithë populli dibran", theksoi kryetari i bashkise Peshkopi.

"Më mirë një mik, se një thesar", - thotë një fjalë e urtë dibrane, - theksoi ne fjalën e tij mbyllëse kryetari i qarkut, z. Naim Gazidede. Kështu ne sot kemi miq Ambasadën e Mbretërisë së Holandës dhe SNV, të cilat na krijuan të kemi në dorën tonë 4.6 milionë Euro, të cilat nuk janë pak për rajonin tone, por që kërkojnë punë, angazhim, profesionalizëm, ndershmëri në menaxhimin e tyre nga të gjithë. Në do të punojmë, që ky fond të bëhet një thesar për banorët tanë, me rrugë të asfaltuara, me ujë të pijshëm, me tregje, qendra shëndetësore, shkolla, etj. Në këtë mënyrë, ne do të dimë të jemi dhe miq të mirë të popullit holandez dhe atij Europian.

Peshkopi, zhvillohet panairi i prodhimeve bujqësore e blegtorale

Drejtoria Rajonale e Bujqesise Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit Diber ne bashkepunim me nje sere aktoresh lokal, duke synuar nxitjen e nje bashkepunimi midis prodhuesve, bizneseve, qeverisjes dhe mbeshtetesve me te mundeshem te rritjes se kontributit te prodhimit bujqesor ne permiresimin e jeteses ne zonat rurale, mendoi organizimin e nje takimi ne te cilin te prezantohen prodhime dhe ide. Duke synuar qe pjesemarresit dhe diskutantet te kene nje njohje me te gjere se sa paraqitet ne panair e nepermjet prezantimeve, u pa e arsyeshme te pergatitet ky dokument me disa nga treguesit qe pasqyrojne rezultatet e arritura, problemet, tendencat dhe nevojat qe kerkohen per mbeshtetje ne zhvillimin bujqesor te rajonit. Dokumenti u mendua te perbehet nga tabela, grafiqe, analiza te shkurtera dhe ide me te cilat pjesemarresit kane mundesine te njihen me shpejt e me gjere me gjendjen aktuale, potencialet dhe tendencat e zhvillimit te rajonit, per tì dhene mundesine secilit aktor te jape kontributin e tij ne mbeshtetje te nje zhvillimi te metejshem bujqesor.



Nepermjet materialeve te shkurtra te ketij dokumenti eshte e vetkuptueshme nevoja urgjente e mbeshtetjes se nje rajonizimi dhe ristrukturimi te bujqesise, duke u perqendruar ne zhvillimin e pemtarise dhe blegtorise si dy nga deget me rentabel dhe te tradites se ketij rajoni.

Edhe pse jemi te sigurte se jo gjithçka mund te pasqyrohet ne nje dokument te tille, ne shpresojme ne angazhimet e aktoreve per nje mbeshtetje me te fuqishme ne zgjidhjen e problemeve qe trajtohen si prioritete te zhvillimit.

THANË PËR MARRËVESHJEN

Ilir Krosi, kryetar i bashkisë Peshkopi:
"Garantoj donatorët dhe të pranishmit, që çdo lekë i marrë do të shkojë sipas projektit dhe puna do të jetë sipas standardeve teknike dhe me cilësi të lartë. Ashtu siç quhet mbështetja financiare "Fondi i Besuar", ashtu do të punojmë dhe ne, që të mos e humbim këtë besim që ka ambasada, qarku dhe gjithë populli dibran"

Zv. Ambasadorja Ardi Stoiosbraken: Ky program ka për qëllim të nxisë mirëqeverisjen në rajonin e Dibrës dhe të ndihmojë në zhvillimin ekonomiko – social, të cilat pjesë e mbështetjes që Komuniteti Europian po jep për Shqipërinë, për të arritur progres në arritjen e standardeve europiane.

BERT VAN NIEUWNHUIZEN, Drejtori Ekonomik i SNV – Ballkan:
Vlerësoj ... natyrën e bukur që ka Dibra dhe karakterin punëtor që kanë dibranët, gjë e cila tregohet dhe në punën e stafit të SNV në Dibër, i cili është më i madhi në Ballkan. Kryetarët e komunave fituese të zbatojnë në kohë dhe në cilësi projektet, pasi ata do të jenë pasqyra e programit dhe një fillim i mbarë i tij.

ZENULLA MEHMETI, Menaxheri i Programit:
Transparenca është një nga vlerat që ka ky program, prandaj po përpiqemi që këtë proces ta bëjmë sa më të kapshëm për të gjithë, me tregues statistikor dhe financiar për çdo projekt.

NAIM GAZIDEDE , kryetari i qarkut:
Ne do të punojmë, që ky fond të bëhet një thesar për banorët tanë, me rrugë të asfaltuara, me ujë të pijshëm, me tregje, qendra shëndetësore, shkolla, etj. Në këtë mënyrë, ne do të dimë të jemi dhe miq të mirë të popullit holandez dhe atij Europian.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI.** Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA.**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Rexhep Torte, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala,**
ADRESA E GAZETËS: **Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.**
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: **lid_gazeta@yahoo.com**

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".
Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROCREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Kur do të shkruhet historia e Dibrës?

Nga SHAQIR SKARRA



Ende mbetet e virgjër treva e Dibrës për studiuesit dhe historianët, për arkeologët dhe gjuhëtarët, për mbledhësit e folklorit dhe etnografët. Ende historia e Dibrës nuk është shkruar. Vitet e fundit janë botuar mjaft studime me bazë fisi dhe fshatrash. Është shkruar për figura patriotësh, por dhe janë vlerësuar figura që nuk i lidh asgjë me patriotizmin dhe atdhedashurinë. Është botuar kanuni, që në fakt Dibra nuk ka pasur një të tillë, por që ka njohur kanunin e Skënderbeut. Janë bërë dhe disa studime spontane arkeologjike, janë botuar dhe studime për rrugët e Dibrës. U botuan në Tetovë dhe dy vëllime me kumtesa të përmbledhura në "Dibra dhe etnokultura e saj" dhe, që në fakt, duhet pranuar që mjaft kumtesa janë vërtet serioze dhe që kanë referenca të plota shkencore, por që të dy këto botime janë botuar me një cilësi mjaft të dobët dhe menaxhimi i tyre ishte enigmë... Dhe vetëm kaq, është botuar të paktën deri tani për historinë e Dibrës.

Po a mjafton kjo? A është historia e plotë e Dibrës kaq sa është shkruar?

Unë them jo.

Të gjitha këto janë bërë nga individë të veçantë, ku dikush nga pasioni dhe dikush nga paraja e paguar janë munduar të hedhin themelet mbi godinën e ardhshme të historisë së shkruar të Dibrës. Kjo është një punë që dhe duhet përgëzuar, ani pse pena ka rënë në dorë të jo profesionistëve. Dibra është ajo trevë e vendit tonë që ka një histori të lashtë. Nuk është një emër i vonë, siç mundohen të thonë mjaft studiues. Emri i Dibrës lakohet qysh në periudhën e qytetërimeve ilirike dhe vetë emërtesa mund të jetë e tillë, duke u bazuar nga fisi ilir Dober.

Kanë kaluar nëpër Dibër princër dhe perandorë, gjeneralë dhe ushtarë, albanologë dhe studiues, gjeografë dhe mbledhës folklori. Në Dibër ka kaluar dhe vetë Filipi i Maqedonisë. Këtej thuhet se ka kaluar dhe vetë Aleksandri i madh, ndryshe nuk ka se pse të ekzistojnë toponimet me emrin e tij. Këtej kanë kaluar gjeografë dhe historianë grekë dhe romakë. Kanë mbajtur shënime, kanë botuar dhe kanë përpiluar harta të plota. Harta e Ptolemeut na bind se Dibra është vëzhguar qysh herët nga të huajt. Kanë ardhur këtu më vonë Jastrebovi dhe Hanni, Edit Durham, inxhinieri austriak Karl Steinmetz dhe frati kroat Levro Mihacevic, Antonio Baldacci dhe At Zef Valentini si dhe shumë të tjerë. Shumë prej tyre kanë mbrojtur dhe grada shkencore. Disa nga këto studime që flasin për Dibrën janë botuar dhe përkthyer më së fundi dhe në gjuhën shqipe. Megjithatë, mjaft studiues që kanë kërkuar në arkivin tonë kanë gjetur dhe mjaft materiale dhe studime me vlera për Dibrën në gjuhë të huaj. Disa janë thjesht dorëshkrime dhe disa edhe të botuara, por jo të përkthyera. Kështu, jo vetëm në arkivin e shtetit, por dhe në Institutin e historisë, në Bibliotekën Kombëtare, në Akademinë e Shkencave dhe në Muzeun e Peshkopisë ndodhem mjaft studime që kanë mbetur të papërkthyera. Mjafton vetëm të mblidhen dhe të botohen shënimet që kanë lënë të huajt për Dibrën në një libër: "Dibra në optikën e të huajve", që besojmë se ka vlerë për të gjithë dibranët. Por kjo nuk mund të realizohet nga amatorët, por penën duhet ta marrin në dorë profesionistët dhe besoi se Dibrës nuk i kanë munguar asnjëherë studiues të tillë.

Ka dhe mjaft dorëshkrime të vetë studiuesve dibranë si Haki Stërmilli, Ismail Strazimiri, Haki Sharofi dhe deri tek prifti shkodran Anton Mazreku, që ka mbledhë mjaft folklor nga Dibra. Të gjitha këto sot po mbesin thjesht si relike të një kohe të largët, pasi shumica e studiuesve, qofshin këto profesionistë apo dhe amatorë i kanë përvetësuar pa të drejtë autori, duke i bërë kështu pronë të vetën. Piratët, tashmë, e kanë kryer misionin e tyre dhe këto dorëshkrime nuk i vlejnë më askujt dhe jo më një studimi për historinë e Dibrës.

Në këtë truall të lashtë ka lindur heroi i kombit Skënderbeu. Këtu kanë lindur gjeneralë dhe shtatmadhorë, të cilët u bënë njësh me popullin, duke luftuar në të njëjtën llogore. Dibrën ka ardhur ta shkelë dhe vetë Sulltani. Historia e Dibrës është e mbushur me heroizma dhe poshtë tokës dibrane ende rënkojnë eshtrat e të huajve, që nuk u tretën në vendin e tyre. Dibra ka lindur lindur patriotë si: Elez Isufi, Ramiz Daci, Llesh Doçi e Salë Markja, Salë Demira e Haziz Xheka, të cilët bashkë me popullin, pushkën e mbanin pa gjalmë dhe syrin pa gjumë, kur vinte puna për mbrojtjen e vendit të tyre.

U botua para disa vitesh libri i Bajram Xhafës me titull "Lufta e Dibrës", me kontribut të Bashkisë së Peshkopisë dhe mirë u bë. Po a mjafton vetëm ky studim, pasi edhe ky flet për një periudhë të kufizuar? Pse vetëm gjatë viteve njëzet është futur në histori Dibra? Dibranët kanë qenë në oborrin e Ali Pashë Tepelenës dhe në ndihmë të vëllezërve të tyre shkodranë, në Mal të Zi dhe Plavë e Guci... Dibranët drejtuan Lidhjen e Prizrenit, bënë disa kuvende dhe kongrese. Ja, pra, pse themi se historia e Dibrës nuk është shkruar akoma. Ende, mjaft studiues nuk e thonë me profesionalizëm se emri i Dibrës është i lashtë, se 13 qytezat ilire ishin pikërisht në luginën e Drinit të Zi, se harta e Ptolemeut i ka mbyllur shtigjet për hamendje të gabuara. Në Dibër u ngritën dy çeta partizane dhe brigada e 18 sulmuese dhe prapë nuk është botuar historiku i Luftës Nacionalçlirimtare.

Dibra e ka shtruar herët sofrën e arsimit jo vetëm nga Said Najdeni e Josif Bageri, por dhe nga vëllezërit kolonjarë Qiriazi dhe akoma nuk ka një histori të arsimit të Dibrës, në një kohë që treva më të vogla se Dibra ka kohë që e kanë botuar një histori të tillë. Në arkivin e Institutit të Historisë ndodhet Defteri turk i Vilajetit të Dibrës i vitit 1467. Është, ndoshta, i vetmi defter turk që ende nuk është i botuar. Janë botuar të gjithë këto defterë që qeveria e atëhershme turke bënte mbi regjistrimin e popullsisë, duke filluar nga jugu deri në Shkodër e Prizren. Defteri i vilajetit të Dibrës, që i përket vitit 1467, ende nuk është botuar si libër më vete. Ai është i përkthyer nga i madhi Vexhi Buharaja dhe ndodhet i daktilografuar në një dosje të veçantë në arkivin e Institutit të Historisë. Ky defter ka pak faqe të daktilografuara, por që kanë një informacion të mjaftueshëm për të gjithë dibranët. Studiuesi dibran Ali Hoxha është marrë gjatë me defterin turk të vitit 1467, por edhe ky ka mbetur në formën e një dorëshkrimi. I ndjeri Hilmi Sadikaj përktheu Jastrebovin, vetëm pjesën që fliste për Dibrën, por dhe ky ka mbetur në formë dorëshkrimi, që aktualisht ndodhet në muzeun e Dibrës dhe Institutin e Historisë. Dibranët janë mjaft të ndjeshëm karshi historisë, por nuk di sesi kanë mbetur mjaft materiale të papërkthyera dhe më së shumti në formë dorëshkrimesh. Historia e Dibrës nuk nis dhe as mbaron me këto dorëshkrime, që tashmë i ka mbuluar pluhuri nëpër skeda arkivi, muzeu apo biblioteke. Historia e saj nuk është as Burimi, as Grazhdani, as Begjuneci, ku janë bërë disa gërmime arkeologjike. Pjesë e historisë së Dibrës është dhe Gramatika (Grama), Tallamazi (Kala e Dodës), Gradishta (Limjan), Makishti (Sohodoll), Xharxhishti (Lurë). Historia fillon me arkeologjinë, ku siç duket Dibra nuk është pjesë e projekteve të Institutit të Arkeologjisë. Pjesë e historisë së Dibrës është dhe Sfetigradi e Torviolli, Vajkali dhe Bulqiza, Gjorica dhe Lanë Lura, Kaushi dhe Shumbati, Çidhna dhe gjithë lugina e Drinit të Zi. Sot, sipas burimeve të sigurta, disponohen studime me vlerë nga Iljaz Kaca, Adem Bunguri, të cilët kanë punuar vite me radhë. Naim Plaku është një arkiv i gjallë i folklorit të Dibrës. Është tamam koha që të mos i lëmë këto studime të na humbasin, ashtu siç kanë humbur apo janë studime të Hilmi Sadikajt, Haziz Ndreut apo dhe Hilmi Kolgjegjës. Nesër do të jemi fajtorë vetë, ne dibranët, që nuk mundëm ta shfrytëzojmë këtë arkiv të gjallë njerëzor që disponojmë sot. Le ta marrin në duar penën profesionistët dhe jo amatorët. Historia nuk shkruhet me pasione dhe para, por nëpërmjet fakteve dhe burimeve arkivore. Ai pluhur që ka rënë gjatë këtyre viteve duhet fshirë dhe e vërteta të dalë lakuriq përballë lexuesit dibran. Ta zhveshim historinë nga politika. I takon bashkisë në bashkëpunim me qarkun që të ngrejë një grup pune dhe të fillojë të shkruhet historia e Dibrës. Studiuesit që do të merren me këtë punë kanë mjaft gjëra të mira për t'i thënë lexuesit. Mjafton të jenë këmbëngulës dhe punëtor të zellshëm, të futen nëpër arkiva dhe biblioteka, të marrin e të përkthejnë me profesionalizëm ato dorëshkrime që ende nuk njihen mirë. Atëherë, po, mund të themi se dhe Dibra ka pasaportën e vet, ka historinë e saj të shkruar.

MA RINOVE SHPIRTIN OR MANUKA I SELISHTËS

Nga **ABDURRAHIM ASHIKU**
Athinë

E mata disa here derisa e preva të publikoj në gazetë telefonin familjar dhe celularin vetjak. Ndjej se kam bërë mire. E them këtë sepse tashmë e ndjej se e jetoj jetën më aktivisht. E them këtë sepse tashmë e ndjej veten jo vetëm në Athinë ku kam nëntë vjet i ngujuar, por edhe në treva të tjera greke. E them këtë sepse tani e ndjej veten më pranë vendit tim, e ndjej veten në Shqipëri, në dheun ku linda dhe u rrita, atje ku gurët e gjëmbat më gjakosnin këmbët e zbathura, majmaleve të lartë duke kapur retë…

Një telefonatë nga Mitilini më ngjiti në bjeshkët e Hynoskës. Më ngjit javë për javë sa here më merr Beni i Ilnicës…

Një telefonatë nga Korfuzi më zbriti në luginën e Drinit. Më zbret sa herë më merr në telefon Ibrahimi nga Muhurri...

Për ta kam shkruajtur...

Sot më mori në telefon një burrë nga Manukajt e Selishtës, Guri e quajnë. Është mësues. Ka mbaruar për anglisht dhe gjermanisht. Më mori nga Kavalla në veriun ekstrem të Greqisë. Punon në peshkim, një ndër punët më të lodhëshme dhe më të vështira...

Në atë bisedë të shkurtër takuam të njohurit, Mevlud Bucin me të tjerë. E kemi lënë të takohemi përsëri në telefon dhe në internet. Kjo e fundit më gëzoi: Shqiptarët, edhe në skaje të largëta të Greqisë, dijnë të lidhen me kohën, dijnë ta tregojnë kulturën e tyre...

Mua nuk më pritet, kam ngrënë „zallnec", kur themi në anët tona, dhe po eci përpara, po e ftoj birin e Manukajve në një udhëtim në dheun e tij, në një...

UDHËTIM NËPËR "KATËR GRYKËT E MURRËS"

Kështu quhet në emërtimin popullor. Kështu quhet edhe në emërtimin e „Nëntë Maleve të Dibrës". Katër fshatrat:- Selishta, Lukani, Kacnia dhe Qafë - Murra i rrjedhin ujrat duke i bashkuar në Lunarë. S elishta matet me Lukanin, i bëjnë karshillëk njeri tjetrit. Janë në një garë se kush do t'i hedhë themelet e shtëpive më lart. Lukani afrohet paksa nën Qafën Lukanjake. Dritaret nuk arrijnë të shohin bukurinë e madhështinë e bjeshkëve të Pllajës ku mërzjejnë që nga qershori e deri në tetor kope të mëdha delesh e qëngjash. Ama pyllin e thanave, atë që shtrihet lart e poshtë rrugës që të çon në Krue të Zi e prej andej në Hurdhë Muhurr, Shqath e Bulaç, masivi më i madh i thanave në vend, e ka si në pëllëmbë të dorës...

Selishta shkallë shkallë u ngjitet maleve të Pratit. Shtëpia me themele më të larta në male është ajo e Budinëve. Gjëja më interesante dhe më e paharrueshme në këtë kullë është "Pusi i Kurt Budinit". Duket disi e çuditëshme që në shtrungë të burimeve malore dikush të ketë hapur një pus. Nuk është një pus i zakonshëm, është një pus që i merr ujrat direkt nga akujt e nëndheshëm, akuj shekullorë. Kur pi ujë nga ai pus vetvetiu të shpërthen nga shpirti fjala falenderimore. Kur e dëgjon këtë Kurti shtëpia e tij hapet në dyer e dritare, e kafja i jep aromë shtëpisë e malit të tërë...Selishta ka pasuri pyllin e Pratit. Ka pasuri dhitë dhe kecat. Ka edhe një "minierë" guri me të cilin bëhen betone e mure që nuk i çan as topi, ka edhe një minierë mermeri me damarë të kuq si gjaku...

Qafë – Murra është fshati më i gjatë jo vetëm ndër Katër Grykët por edhe në tërë Dibrën. Shtëpitë e saj fillojnë në Lunarë, i ngjten në të dy krahët lumit të Murrës, pushojnë paksa në Palpus dhe

> ***T'mujshe edh' un' me fluturue,***
> ***dojsh edhe un' me u nisë me ty,***
> ***m'e pa prap at vend me sy!***
> ***(Filip Shiroka « Shko dallëndyshë»)***

marrin rrugët djathtas e majtas, njera në drejtim të Monasdrenit e tjetra në drejtim të Kalasë së Skënderbeut. Nuk mjaftojnë tre orë rrugë për të matur me këmbë tërë gjatësinë e Qafë – Murrës. E majta e fshatit, kur ngjitesh lart, ka një pyll madhështor ku mërzejnë dhitë dhe kecat. E djathta ka pllaja të bukura verore ku mërzejnë delet e qingjat.

Manazdreni është lagjia më e bukur e Qafë Murrës, është një ballkon malor nga ku ke në pëllëmbë të dorës tërës luginën e Matit, që nga Klosi, në Burrel e deri tutje ku liqeni i Ulzës, si një gjethe e stërmadhe hardhie, merr dhe i jep qiellit kaltërsi. Kush ka qenë në Qafë Murrë dhe nuk është ngjitur në Monasdren ka humbur jo vetëm bukurinë poshtballkonore por në veçanti atë që ngjitet lart malit, në çati të tij, gjelbrimin e mrekullueshëm të pishave dhe...begatinë e tij, begati për të cilën do të flasim kur të t'i ngjitemi anës tjetër të tij.

Kështjella e Skënderbeut, Kështjella e Stelushit siç njihet në histori, ndryn në vetvete shumë ndodhi e legjenda. Njera prej tyre lidhet me Skënderbeun dhe kërcimin nga njeri kep në tjetrin të kalit të tij. Gjurmët e patkojëve të kalit unë nuk i kam parë. Vendasit të betohen se ata janë mbi shkëmb të gjalla si të ishin ngulur dje.

Me Qafë – Murrën më lidh një kujtim i vjetër i rinisë së herëshme, atëhere kur shërbeja si agronom i mesëm në lokalitetin e Muhurrit. Është një kujtim që 45 vitet e jetës së mëvonëshme nuk e kanë shuar. Ishte pikrisht maji i vitit 1960, dita e Shën Kollit, 22 maji, ditë që në Katër Grykë ashtu si edhe në Çidhën, Lurë etj. festohet prej mijëra vjetësh, ditë e cila ndonëse ka një emër pas kristian, ritet e zakonet janë shumë më të herëshme, rite pagane. Në shtëpinë e kulturës (Qafë – Murra është një fshat me kulturë e tradita të spikatura në tërë Malet e Dibrës), ndër të tjera kishte edhe një radio. Jo një radio me energji elektrike, sepse kjo do t'i vinte fshatit një dekadë më vonë, por një radio me vajguri. E kam në sy llampën që ndriçonte sallën, "gjeneratorin" që merrte nga gypi i qelqtë i llampës nxehtësinë për ta kthyer në energji elektrike, dhe aparatin që përcillte këngët e Radio – Tiranës. Vite më vonë, sa herë hyja në atë shtëpi modeste kulture, vështrimi më ndalej tek "qoshku i radios me vajguri". Radioja nuk është më. Ajo me kohë u zëvëndësua nga radiot me bateri, radiot me energji elektrike, televizorët bardh e zi, televizorët me ngjyra, kompjuterat, interneti. Me siguri Guri i Manukajve, mësues, emigrant në një zonë të thellë të Greqisë, do të ketë një adresë interneti me Selishtën...

SHTRUNGA E KACNISË

Me fjalën "shtrungë" blegtorët kuptojnë një vend të ngushtë në fund të vathës së thurur me purteka ku delet apo dhitë detyrohen të lëshojnë qumështin e çmuar që përcjell jetën e tyre në tryezat njerëzore. Shtrunga është kështu vendi ku milen bagëtitë e imëta. Në Kacni me fjalën "Shtrungë", si fjalë e përcveçme e shkruar me gërmë të madhe, kuptojnë vendin ku milen malet, vendin ku burimet mblidhen dhe duke rënë në theqafje të njëpasnjëshme malore, shkumzojnë ashtu siç shkumbëzon qumështi kur vlon në kusitë e bakërta...

Kacnia është një fshat i vogël, një fshat që ka sipër "një batanie qiell". Shtëpitë i ka të vendosura në të dy anët e një përroi me shtrat të thellë e të ngushtë, përrua që mjel tërë malet në lindje të Katër Grykëve...

Nga Kacnia, një rrugë malore e shtruar me kalldrëm e çakëll të merr në një litar dredhash midis pishash shekullore e të ngjit në minierën e Kromit. Jo ndoshta por me siguri kjo është miniera më e lartë në vend. Galeritë e saj i ngjiten malit deri në afërsi të majës. Zbresin edhe poshtë deri në Monasdre. Kromi është një pasuri e veçantë e zbuluar e këtyre maleve "të humbur" të vendit. Mermeri i kuq dhe guri për ndërtime të cilësisë së lartë janë një tjetër pasuri e "njohur" e këtyre maleve. Ka edhe të tjera pasuri nëntoka e kësaj zone, pasuri që lidhen me minerale të rrallë e me vlera të mëdha. Këtu, në minierën e maleve të Kacnisë është një traverbank që syun e ka pas të shikojë Bulqizën. Edhe nga Bulqiza është një traverbank që syun e ka të shohë Kacninë. Thashë "syun e ka" në një kohë që duhet të thosha se "syun e kishte". Shumë gjëra që dje bënë hapa drejt thellësive, ndër të tjera edhe dy traverbanket paralelë të Klosit që synonin nivelin e pestë të nëntokës së Bulqizës apo Rampa e Qafës së Buallit tani kanë humbur nga kujtesa e kohës...

Nga Kacnia në Shtrungë jam ngjitur më këmbë vetëm një herë. Ishte fundi i muajit maj të vitit 1982. Ndër udhëtimet e mija në këmbë ai ka qenë më i bukuri i jetës sime. Një ditë e bukur maji kur lulet dhe zogjtë zgjojnë natyrën e sythet e drurëve çahen duke nxjerrë gjethet e filizat e ripërtritjes së jetës. Një përrua me ujëvara që lidhin njera me tjetrën shkumën siç lidhen rruazat e perlave në qafën e të Bukurës së Dheut.Trofta malore që pasi mbështesin bishtin e tyre mbi gurët e ujvarave kërcejnë e ngjisten drejt burimeve malore. Dikur, në një reportazh, pata hedhë disa penelata mbi këtë bukuri ngjitjeje ashtu siç pata hedhë mbi bukuritë që fshihen pikërisht në krye të kësaj shkallarje natyrore, bukurinë e Shtrungës...

Livadhe me lule, burime që i mbledhin ujërat në një prrua të qetë në kërthizën e tyre. Trofta të vogla që shkumohen nën ujin e akullt. Plloska dëbore midis gjelbrimit ...Nuk të mbetet gjë tjetër veçase të ulesh në gjunjë e me sytë drejt pastërtisë kaltërore të qiellit të lutesh i befasuar. Ishte një bukuri e virgjër, bukuri që e kishin shijuar vetëm barinjtë e Kacnisë, dendrologët dhe gjeologët...

Por kjo nuk është asgjë përballë asaj që do të shihja më vonë, asaj që do të shihja duke iu ngjit lart e më lart malit. Liqejtë e Kacnisë janë liqenet më të bukur që kam parë në jetën time. Unë kam parë dhe kam jetuar me javë midis liqeneve të Lurës. Kam rrahur me këmbë fushën e mrekullueshme të Pelave. Jam ngjitur kreshtës së malit nga ku në një krah kam parë bukurinë që shpaloset me Zall-Gjoçajn, Matin e Mirditën dhe nga ana tjetër bukuritë që lidhet me Lurën, Gjagjishtin, e tej e më tej me Korabin. Janë vende me të vërtetë të bukura në të cilat ndonjëherë do t'a ul këmbëkryq mallin tim. Por liqenet e Kacnisë janë më të bukurit e më të bukurve. Një mbi një, në tre-katër taraca natyrore malore, ata kanë parë dhe janë parë për mijëra vjet me qiellin. Kur je në breg të tyre të duket vetja si pjesë e tyre. Kur i ngjitesh malit, nga rrafshnalta e të cilit syu rrokulliset drejt Bulqizës nga jugu e drejt liqeneve të Balgjajt e më tej drejt Matit, e ndjen veten se je Zot i natyrës.Kur e zbret shikimin poshtë, mbi liqenet e Kacnisë e ndjen veten se je eksplorator i vetëm i një vendi dhe bukurie që nuk përshkruhet...

Kam bërë shumë fotografi të liqeneve e të natyrës së bukur. Kam bërë në qershor. Kam bërë edhe në korrik e shtator kur kam udhëtuar drejt tyre me makinë nëpër një rrugë verore që në atë kohë kërkonte që liqeneve e natyrës t'u jepej një kuptim tjetër, t'i zgjonte e t'i bënte pjesë të jetës. Për to kam shkruar rreth një çerek shekulli më parë. Sot nuk po shkruaj gjë. Edhe liqenet, edhe pasuritë dhe bukuritë e mëdha të kësaj zone ndër më të bukurat dhe më të begatat e vendit, janë këthyer në gjumin shekullor. Ndoshta ndonjëherë dikush do t'i zgjojë. Atëhere, vetëm atëhere, do të thoja (në qoftëse do të jem gjallë) se Shqipëria është në rrugën e madhe të Evropës, në rrugët e Svicrës (për të cilat flasin pa kokë politikanët tanë në fushatat elektorale).

BARDHËSIA E KATËR GRYKËVE TË MURRËS

Gjëja më e fundit që më është mbyllur në kasafortën e kujtesës (së cilës i ka humbur çelësi) është bardhësia reflektuese e Katër Grykëve të Murrës, bardhësia e dëborës, bardhësi e cila është një me bardhësinë e shpirtërave të banorëve të saj...

Në dimrin e vitit 1985, në atë dimër ku çatitë e kullave ishin rrafshuar me dëborën, më qëlloi të udhëtoj nëpër të Katër Grykët e Murrës. Nuk e di se si ishte dimri i vitit 2005, por di se ai dimër ishte më i vështirë se ai i vitit 1954 apo ai i vitit 1967. Tre ditë u ngujuam në Muhurr derisa një gjurmë këmbësh lidhi ultësirën e Drinit me malet e Selishtës. Nuk mund ta haroj kurrë atë rrugë më këmbë, ngjitjen në të përpjetën e Gurit tëKuq ku çdo hap përpara shoqërohej me një rrëshqitje dy hapa prapa. U nisëm në mëngjes dhe arritëm në Selishtë në mbrëmje duke u errur, bëmë një ditë të tërë rrugë kur normalisht do të kishim bërë dy orë.


Të nesërmen mëngjesi na ofroi një pamje mahnitëse. Dëbora kishte pushuar dhe mbi qiellin e kaltër shëndriste dielli. Shëndriste lart dhe llamburiste poshtë. Nuk ka gjë më të bukur se sa një ditë me diell lart e dëborë poshtë. E zakonshme është kjo bukuri kudo por e jashtzakonëshme është kur ajo ka për sfond bukuritë e Selishtës, Lukanit, Qaf Murrës dhe Pratit. Udhëtuam për katër ditë nën diellin që shkëlqen lart dhe dëborën që reflekton poshtë. Udhëtuam nën një temperaturë që në mesditë shënonte dymbëdhjetë nën zero e para lindjes së diellit shënonte njëzet poshtë zeros. Nga Selishta zbritëm deri në rrjedhën e Murrës për t'u ngjitur në Lukan e për ta kaluar natën në shtëpinë më afër qafës së Lukanjakëve, në krye të fshatit. Në atë kullë pata bujtë e pata pirë kafe në vitin 1960 me Lam Tahirin që pendë me Lok Zhuzhin e Bulaçit, kur hidheshin në luftë kundër serbit, përvishnin krahët deri në brryl e thirrja "Besa besë Burra!"i bënte njerëzit male mbi male...

Të nesërmen kaluam qafën e malit dhe zbritëm në Murrën e Vjetër. Më tej zbritëm në Qafë Murrë e bujtëm në kullën e Lalajve. Të pasnesërmen zbritëm luginën e kaluam nëpër Kacni për t'u ngjitur më tej në krye të Selishtës. Më tej u ngjitëm në Prat e më pas në lartësi të maleve për t'u takuar me sharrëtarët që kishin ardhë nga Luznia e Selishta dhe kishin filluar punën e tyre të përditëshme...

Atëhere pata bërë një reportazh me vijim në disa numëra në gazetën lokale, reportazh që fliste për bardhësinë e dëborës në male dhe për bardhësinë e njerëzëve mbi male...

Sukses i teatrit në Dibër

Përfundoi Festivali i gjashtë "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"





Shfaqja më e mirë, "Hanibali i Nëntokës"-Gjakovë

Çmimin "Shfaqja më e mirë" e mori "Hanibali i Nëntokës"-Gjakovë, regjisorja më e mirë u shpall Driada Dervishi - Durrës, aktorët më të mirë u shpallën Dritan Boriqi - Vlorë dhe Veton Osmani - Gjilan

Nga REXHEP TORTE

Festivali i gjashtë "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007 " që zgjati nga data 4 -11 shtator dhe ku morën pjesë trupa teatrore nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova, ishte kënaqësi e madhe shpirtërore për tërë artdashësit. Spektatorët dibranë së bashku me mysafirët patën rastin të shijojnë arritje të bukura vlerash teatrore. Secili artdashës do ta kishte dëshiruar të jetë në sallën e madhe të Qendrës për Kulturë në Dibër në këtë eveniment kulturor, ku u shfaqën 11 shfaqje konkurruese dhe dy përshëndetëse nga trupat teatrore nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova.

Këtë festival me praninë e tyre e nderuan artistët e popullit, Reshat Arbana, Margarita Xhepa, Drita Pelingu, Agim Doçi etj. Ne mesin e tyre ishin edhe Ali Ahmeti, Gëzim Ostreni dhe kryetarët e komunave Nevzat Bejta - Gostivar, Ramiz Merko - Strugë, Izet Mexhiti - Çair.

Ky festival përfundoi me Teatrin Kombëtar nga Gjakova, i cili në ora 20.00 të ditës së martë, shfaqi dramën "Hanibali i Nëntokës" të autorit Hristo Boçev, me regji të Kushtrim Koliqit. Aktorët gjakovarë Armond Morina, Arta Muçaj, Ylber Bardhi, Gresa Pallaska dhe Besart Sllamniku spikatën cilësi të lartë aktrimi.

Pas kësaj, në praninë e spektatorëve, të aktorëve, regjisorëve, juria e përbërë nga Prof. Enver Petrovci, kryetar, dhe anëtarët Prof. Minella Borova dhe aktori Genci Mirzo, shpalli fituesit e çmimeve.

Enver Petrovci, me këtë rast, theksoi se: "Këtu u paraqit një pjesë e hapësirës teatrore të trevave shqiptare. Dramaturgjia e larmishme u paraqit nga krijuesit e teatrit me entuziazmin, dëshirën artistike dhe talentin artistik. Kjo gjeneratë e re i është afruar teatrit me dashuri, duke i kombinuar përpjekjet jo të lehta për të zgjedhur jetën e tyre brenda artit e teatrit dhe ky zotërim i të rinjve u ndje këtu plotësisht. Vazhdimësia dhe këmbëngulja për ta kryer këtë festival është në favor të teatrit, i cili do të jetojë suksesshëm vetëm me nivel të lartë artistik. Janë për të përshëndetur e çmuar diskutimet artistëve, dramaturgëve, kritikëve. Dua të përshëndes publikun e mrekullueshëm të Dibrës, që na i bëri kaq të këndshme këto ditë të teatrit".

Çmimi inkurajues për shfaqjen "Rëndësia e të quajturit i ndershëm" të Teatrit "Petro Marko"- Vlorë, iu dha aktores së re Eliona Thomaraj. Çmimi i karrierës iu dha aktorit Jashar Shahiq, aktor i Teatrit Kombëtar - Gjilan, për rolin në dramën "Gomari diversant". Çmimi aktorja joprotagoniste për shfaqjen "Rëndësia i quajtur i ndershëm" e Teatrit "Petro Marko" Vlorë, iu dha aktores Desantila Kristo. Çmimi aktori joprotagonist, për shfaqjen "Njerëz dhe minj" të Teatrit "Qemal Ajdini" - Dibër dhe "Sofra" - Strugë, iu dha aktorit Ylber Myrtezi. Çmimi "Qemal Ajdini" për aktorin më të mirë në shfaqjen "Vajza pa prikë" e Teatrit "Aleksandër Mojsiu" - Durrës, iu dha aktorit Dritan Boriqi dhe aktorit Veton Osmani, aktor i Teatrit Kombëtar – Gjilan, për rolin në shfaqjen "Gomari diversant". Çmimi regjia më e mirë iu dha regjisores Driada Dervishi për shfaqjen "Vajza pa prikë" e Teatrit "Aleksandër Mojsiu" - Durrës. Shfaqja më e mirë e festivalit që fitoi çmimin "Sulejman Pitarka" u shpall "Hanibali i Nëntokës" luajtur nga aktorët e Teatrit Kombëtar nga Gjakova.



Driada Dervishi



Veton Osmani



Dritan Boriqi

Ali Ahmeti, lider i BDI-së, duke i përshëndetur të pranishmit, u shpreh se: "U besoj emocioneve që shprehën artistët këtu me rastin e ndarjes së çmimeve. Këto çmime nuk kanë kosto milionëshe, por janë çmime dhe emocione që burojnë nga shpirti e zemra dhe ky është çmimi më i lartë. Këtë festival e madhëron edhe prania e artistëve të popullit si Reshat Arbana, Agim Doçi, Margarita Xhepa, Drita Pelingu etj. Ne jemi rritur me këta artistë të mëdhenj. Të inspiruar nga fjala e tyre të artë, kanë rënë me dhjetëra e qindra shokë tanë në betejat për lirinë e Kosovës dhe për barazi të shqiptarëve në Maqedoni, që ne të jetojmë si popull i lirë, i barabartë në hapësirën tonë që na takon. Ju artistë të mëdhenj keni dhe hisen tuaj, sepse nuk është punë e vogël. Ju keni ndikuar që ne të luftojmë për liri, sepse ju na mësuat përmes teatrit, na mësuat përmes mikrofonit dhe heroizmit të popullit tonë ndër shekuj dhe shumë emisioneve që ju i keni bërë për ne pjesën e ndarë të atdheut. Industria e artit është njëra nga industritë më të mëdha të njerëzimit. Për fat të keq nuk ka njerëz që këtë industri ta kuptojnë drejt, sepse po të investohet në këtë industri, sigurisht që njeriu do të ishte shumë më lart. Teatri shqiptar do të mbijetojë, deshi apo s'deshi dikush, sepse ka mbijetuar ndër shekuj".

Ylber Nuredini, drejtor i festivalit, tha se: "Falenderoj jurinë dhe kritikët Prof. Dr. Adriatik Kallulli, Prof Dr. Nebi Islami, Prof.Dr. Josip Papagjoni, Prof Dr. Stefan Çapaliku dhe Prof. Selajtin Salihu, për angazhimin e tyre që gjatë analizës së shfaqjeve u tregonin aktorëve e regjisorëve ku është pika e dobët dhe si duhet ecur më mirë. Falenderoj edhe kryetarin Argëtim Fida për angazhimin e tij për mbajtjen e këtij festivali me shpenzimet e tërësishme të komunës. Apeloj që ky festival të mbështetet edhe nga Ministria e Kulturës.

Falenderoj drejtorët e teatrove, aktorët, regjisorët dhe mediat që ndoqën këtë festival. Uroj që festivali të jetë i përjetshëm.

Fituesve të çmimeve iu dorëzuan mirënjohje, skulptura artizanale druri dhe të holla.

Fituesit, duke falenderuar për çmimet që morën, theksuan respektin për spektatorin dibran dhe gatishmërinë e tyre për suksese më të mëdha në të ardhmen.

Argëtim Fida, kryetari i komunës së Dibrës, duke deklaruar të mbyllur këtë festival, falenderoi qytetarët dibranë, mysafirët, aktorët, regjisorët dhe mediat për punën e tyre të shkëlqyer.

POSTFESTIVAL

JU LUMTË DIBËR!

Nga **VALBONA ZUNÇE, ATLI DEMA**

Më 4 shtator Dibra ngriti siparin e edicionit të gjashtë, të Festivali "Teatri Shqiptar në Maqedoni" –Dibra 2007. Në Qendrën për Kulturë Dibër, për tetë net me radhë pa alternativë u shpreh potenciali artistik i 11 trupave teatrore, të cilat nuk kishin qëllimin që të fitojnë në garë, por të marrin pjesë dhe me shprehje prezantuese artistike të kënaqin spektatorin.

Në festival morën pjesë 11 ansamble nga trojet shqiptare Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, nëntë trupa teatrale morën pjesë në sistem garimi ndërsa dy trupa në cilësinë përshëndetëse.

Festivalin e gjashtë "Teatri Shqiptar në Maqedoni"–Dibra 2007, e përmbylli shfaqja "Hanibali i Nëntokës", autor Hristo Bojçev, me regji të realizuar nga Kushtrim Koliqi.

Më pas juria e përbërë nga Enver Petrovci kryetar, Minella Borova anëtar, dhe Genci Mirzo anëtar, në prezencë të mysafirëve të shumtë, artisë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe publikut artëdashës dibran ndau 8 (tetë) çmimet përkatëse:

Në interes të ngritjes së cilësisë së Festivalit po shënojmë disa vërejte dhe sugjerime, të cilat janë sugjeruar si nga kritikët, aktorët, po ashtu edhe nga spektatorët rreth Festivalit të Teatrit Shqiptar në Maqedoni

1. Në këtë edicion të festivalit munguan trupat e Teatrove Kombëtare, Tiranë, Prishtinë e Shkup. Këtë lëshim, sigurisht, që nuk do ta përsërisin në të ardhmen, sepse nuk duhet të frigohemi nga më të mirët, përkundrazi mundemi të mësojmë. Konkurrenca sjell zhvillim. Nëse mendohet që të ngrihen edhe teatrot më të reja apo me pak kualitative, atëherë për hatër të publikut që të shikojë shfaqe edhe më të arrira duhet thirrur trupat kombëtare, dhe të njëjtët fundja le të jenë jashtë konkurencës.

2. Politizimi, apo më mirë me thënë, partizimi i festivalit. Në këtë rast Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ndan çmimin më të lartë të festivalit. Aty ku depërton politika apo partizimi, prishet kultura, sepse partitë janë grupime politike të të njëjtit mendim, ndërsa kultura është e të gjithëve.

3. Prishen kriteret e ndarjes së çmimeve, injorohet femra, nuk ndanë çmimin e aktores më të mirë, por ndanë dy çmime aktorët meshkuj më të mirë.

4. Përsëritja e shfaqjes në festival. Me pjesën "Stjuardesat" vite më parë në festival ka marrë

(Vijon në faqen 6)

POSTFESTIVAL

JU LUMTË DIBËR!

(Vijon nga faqja 5)

pjesë trupa teatrore “Qemal Ajdini” ndërsa përsëritet edhe këtë vit nga trupa teatrore “Uktra” nga Kumanova. Nëse përsëriten kështu shfaqet mund të ndodh që me të njëjtën pjesë në të ardhshmen të paraqitet edhe ndonjë trupë tjetër.

5. Mungon përzgjedhja e shfaqjeve. Nga organizatori nuk janë përzgjedhur shfaqjet për nivelin e përgatitjes, gjë që me pjesët e pa përgatitura mirë e zbehin festivalin.

6. Nuk ndahet çmimi “Sulejman Pitarka”. Drejtoria e Festivalit ‘Teatri Shqiptar në Maqedoni” - Dibra 2007, nuk mban premtimin. (Në edicionin e katërt drejtoria e Festivalit “Teatri Shqiptar në Maqedoni”- në krye me drejtorin, Ylber Nuredini, në vitin e katërt të festivalit vendosën që Festivali të mbajë emrin e aktorit të madh, kolosit të teatrit shqiptar, të dibranit Sulejman Pitarka, por siç na tha atëherë drejtori Ylber Nuredini, këtë gjë nuk e kanë mundësuar organet më të larta, ku janë firmosur dokumentet e festivalit, por tha se çdo vit do të ndahet çmimi “Sulejman Pitarka”. Sivjet ky çmim mungoi, ne u përpoqëm të marrin në kontakt drejtorin e këtij Festivali, Ylber Nuredini, por na iku nga biseda që deshëm ta zhvillonim”.

Prof. dr. Josif Papgjoni, lidhur me këtë çështje tha: “Kjo është një mungesë koherence nga ato që e elaborojnë festivalin. Nuk e di si ka ndodhur, por një gjë kur publikohet apo shpallet siç është emri i Sulejman Pitrarkës duhet të realizohet. Ky emër është një nder që i bëhet Festivalit të Dibrës, sepse vet Sulejman Pitarka, ky kolos i artit dhe njeri i ndritur i skenës shqiptare është dibran, dhe duke qenë dibran është në nderin e Dibrës dhe vet Festivalit që ta ketë këtë çmim”.

7. Për herë të parë këtë vit festivali i Teatrit Shqiptar në Maqedoni u vu nën kujdesin e Këshillit Komunal të Dibrës, të cilin përkrah disa sponsorëve të vegjël, tërësisht e ka financuar komuna e Dibrës së Madhe. Jo përpjekje është për tu përshëndetur, sepse festivali fut themelet e institucionalizimit, por pati thirrje dhe zëra që edhe Ministria e Kulturës së R.M-së të ndajë mjete për Festivalin e Teatrit Shqiptar në Maqedoni.

8. Qendra për Kulturë Dibër, organizatorit, pra komunës së Dibrës, për mbajtjen e 11 shfaqjeve i merr komunës rreth 5 mijë euro për shfrytëzimin e sallës së shfaqjeve.

9. Mbi 6 mijë spektator shikuan festivalin e gjashtë. Vlen për të shprehur se me kulturë dhe në mënyrë dinjitoze, si në edicionet e tjera, edhe këtë edicion qytetarët e Dibrës i kanë përcjellë me interes të madh të gjitha shfaqet.

DIBËR E MADHE - Filloi Festivali “Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007”

Qyteti në festë skenike

Të martën mbrëma filloi Festivali “Teatri shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007”. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, duke e deklaruar të hapur këtë festival, tha se: “Është kënaqësi e posaçme hapja e këtij festivali, të gjashti me radhë. Jo vetëm qytetarët e Dibrës, por tërë artdashësit nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova kanë mundësinë të bashkëjetojnë me personalitetet eminente të artit skenik mbarëkombëtar. Dibra për këto tetë ditë do të gjallërojë shpirtërisht dhe artistikisht. Përshëndes të gjithë regjisorët, koreografët, skenaristët, aktorët, kritikët dhe mediat e pranishme. Nuk mund të lë pa përmendur Drita Pelingun, Margarita Xhepën, Robert Ndrenikën, Adriatik Kallullin, Nebi Islamin, Josif Papagjonin, Stefan Xhapallikun, Enver Perovcin, Dhimitër Orgockën dhe shumë personalitete tjera që do ta madhërojnë këtë festival.

Të njëmbëdhjetë trupat që do ta mbajnë gjallë këtë skenë sot janë të nderuar edhe me personalitetet të jetës shoqërore në Maqedoni dhe Shqipëri. Përshëndes praninë e Gëzim Dopxhiut - kryetarit i bashkisë së Maliqit - Shqipëri, së bashku me stafin e Qendrës për Kulturë, përshëndes Nevzat Bejtën - kryetarin e komunës së Gostivarit, Ramiz Merkon, kryetarin e komunës së Strugës, Sejfulla Hani, kryetarin e KK të Strugës, Rufat Hysenin, kryetar i komunës së Zajazit, Rexhep Selmanin, ish ministrin e Shëndetësisë, Nizamedin Papranikun - kryetarin e KK të Dibrës dhe tërë të pranishmit. Në manifestimin “Ditët e Kulturës - Dibra 2007”, festivali është eveniment qendror. Këtë Festival e financon pushteti vendor, Ambasada e Holandës, Banka Ekonomike, Via Signal dhe EVN. Viteve të kaluara, Ministria e Kulturës e Maqedonisë përballonte gjysmën e shpenzimeve. Kësaj radhe ende nuk kemi marrë përgjigje nga Ministria e Kulturës së Maqedonisë se a do të na ndihmojë financiarisht. Buxheti i Maqedonisë mbushet edhe nga taksapaguesit dibranë dhe ne kërkojmë hisen tonë për këtë manifestim kulturor mbarëkombëtar. Nuk kemi pasur asnjë dokument me shkrim të nivelit shumë të lartë se do të mbështetet ky manifestim kulturor mbarëkombëtar. Dibranët do të japin kontributin e tyre, që ky festival të mbahet edhe në të ardhmen. Dëshiroj që kjo javë të lërë mbresa te të gjithë, sepse dibranët kanë ditur dhe dinë të jenë mikpritës të shkëlqyer”.

Ylber Nuredini, drejtor i Festivalit, duke përshëndetur të pranishmit, prezantoi kryetarin e jurisë së këtij festivali, Enver Petrovcin nga Prishtina dhe anëtarët Minella Borova - aktor nga Shqipëria, Genci Mirzo nga Maqedonia.

Në natën e parë të Festivalit para artdashësve u paraqit Teatri “Qemal Ajdini” nga Dibra dhe Teatri “Softra” nga Struga me dramën “Njerëz dhe minj” të autorit John Steinbeck” dhe me regji të Guri Koços.

Aktorët Dritëro Ame, Hamdi Rashiti, Eliona Thomaraj, Burhan Skikuli, Lindim Etemi, Ylber Murtezi dhe Jeton Zogjani me angazhimin në interpretimin e roleve të tyre freskuan skenën dhe spektatorët.

Regjisori Guri Koço, pas shfaqjes, deklaroi se: “Sipas vlerësimeve të spektatorëve shfaqja e arriti pjesën më të madhe të asaj që kisha menduar. Publiku dibran është i jashtëzakonshëm, i shkëlqyer, nuk e prisja kaq të mirë. Mesazhi i kësaj drame është: “Njerëz, juve duhet të ëndërroni, sepse jeta pa një ëndërr është si një zog pa krahë”.



Njerëz dhe minj

VLERËSIME PËR FESTIVALIN

Prof.dr.JOSIF PAPAGJONI, kritik

Festivali i gjashtë i “Teatri Shqiptar në Maqedoni” – Dibra 2007, mundi të realizojë vetveten në disa parametra dhe më cilësor se vitet e mëparshme. Në këtë Festival në disa nga shfaqet më përfaqësuese dhe më të realizuara u soll një përvojë e bukur artistike me shumë vlera në fushëpamje të aktrimit, aktorë dhe aktore të reja të talentuara dhe shumë qasje interesante regjisoriale, por nuk duhet mohuar dhe disa tekste dhe drama të autorëve të rinj shqiptarë, që ishin më shumë nga Kosova, të cilët edhe pse janë nga fillimi ose afirmimi janë shpresa të reja që i paraqiten Teatrit Shqiptar përgjithësisht.

Prof.dr.NEBI ISLAMI nga Kosova:

Festivali i gjashtë i “Teatrit Shqiptar në Maqedoni” – Dibra 2007, ka qenë ngjarja më madhështore e tërë hapësirës shqiptare, sepse ka tubuar veprimtarët e kulturës nga të gjitha trojet etnike shqiptare. Festivali ka pasur prurje të reja dhe mjaft kualitative, të cilat bëjnë që kultura jonë të bëjë edhe më tutje depërtime cilësore, të cilat janë manifestuar në poetikat e reja që korrespondojnë me të arriturat kulturore skenike në Evropën e sotme bashkëkohore.

EVNER PETROVCI, aktor dhe kryetar i jurisë:

Është një festival i mirë me një publik të mrekullueshëm. Lirisht them se si publiku dibran për momentin nuk ekziston në të gjitha trojet shqiptare. Gjithçka më ka pëlqyer këtu, por i mrekulluar jam nga publiku artëdashës dhe mjaf mikëpritës. Në këtë festival marrin pjesë shfaqet më të mira nga trojet shqiptare, por mendoj se selektimi i shfaqjeve nuk ka qenë në nivel të duhur. Si festival i ri, besoj se në të ardhmen do të bëjë këtë gjë. Mendoj, se për këto ditë mjaftojnë shtatë shfaqe, por organizimi ka qenë në nivele të lartë.

MINELLA BOROVA, anëtar i jurisë:

Ndarja e çmimeve është bërë drejtë, duke marrë dhe pjesëmarrësit dhe shfaqet e shumta. E rëndësishme është se çmime morën ato shfaqe dhe artistë që e meritonin dhe për këtë jam fare i qetë. Festivali doli i suksesshëm, gjë që e tregoi dhe vet niveli i artistëve dhe shfaqjeve.

Yllka Muja, artiste e merituar:

Është kënaqësi shumë e madhe, sepse sido që të jetë dhe ndodh këtu ka përfaqësime teatrosh të ndryshme nga trevat e Shqipërisë dhe në fund të fundit shohim se ku shkon teatri, çfarë rrugë ndjek, çfarë zhvillimesh dhe ndryshimesh ka nga viti në vit. Më vjen keq që nuk përfaqësohen të gjitha trupat, sepse Dibra vërtet është qytet i vogël, por ka një publik të mrekullueshëm, që është për t'u vënë në evidencë dhe është kënaqësi që ke të bësh me një publik të këtillë. Ky qytet e dashuron teatrin dhe është mirë që këtë dhuratë t'ia japim. Prandaj, do doja që përfaqësimi të ishte më i madh.

Festivali i Dibrës është një festival që tregon kulturën e vendeve përkatëse që prezentohen. Teatrot Kombëtare të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit, duhet të prezantohen, sepse kjo është një festë, dhe në festë duhet të festojmë sëbashku, sepse kështu krijohet një marrëdhënie dashurie më e madhe. Pjesëmarrja e tyre ndihmon në mbarëvajtjen e Festivaleve, por gjithsesi ka pasur shumë aktorë të këtyre teatrove që janë përfaqësuar me qytete të tjera, dhe në një farë mënyrë edhe teatrot kombëtare janë përfaqësuar.

Kritikët e festivalit Prof. dr. Adriatik Kallulli, Prof. dr.Nebi Islami, Prof.dr. Josif Papagjoni, Stefan Çapaliku, regjisor, Selajdin Salihu, gazetar dhe krijues, me kujdes ndoqën të gjitha shfaqet dhe në mënyrë transparente në tribunat e kritikave dhanë vlerësimeve për çdo shfaqe veç e veç.

DRIADA DERVISHI, regjisorja më e mirë:

“Jam shumë e lumtur pasi çmimin tim të parë do të doja ta merrja në Dibër. U bë viti i tretë që trupa e teatrit “A. Moisiu” jep shfaqje në këtë qytet dhe aty vijnë trupa nga Kosova – Prishtina, Gjakova, Gjilani, Maqedonia: Shkupi, Tetova, Manastiri, Kumanova, nga Shqipëria – Tirana, Durrësi, Korça, Vlora etj., dhe të gjithë bien në një mendje të përbashkët – spektatori i teatrit që gjendet në Dibër, nuk gjendet në asnjë nga trevat shqiptare.

Dëshira, emocioni dhe ngazëllimi me të cilët dibranët shohin një shfaqje teatri është vërtet imprsionuese, kur shikon gati një mijë vetë të cilët rrinë dhe presin jashtë dyerve të teatrit, pa ndodhur as më i vogli incident, dhe të mendosh se një pjesë e mirë e tyre do të kthehen mbrapsht për shkak se vendet janë zënë me kohë, apo të rinj të cilët ulen në tokë ose qëndrojnë në këmbë pa bërë më të voglën lëvizje, duke ndjekur shfaqjen si të hipnotizuar (jo më të flasin në celular), nuk ke se si të mos ndjehesh e vlerësuar dhe kur ndjen këtë qetësi gati solemne ndërkohë që shfaqja vazhdon dhe salla është mbushur plot e përplot, të gjitha vështirësitë, problemet, pengesat për të arritur deri në atë sallë, harrohen dhe t'i falë këtyre njerëzve mendon se nga teatri nuk do të mund të ndahen kurrë”.

MBRËMJA E DYTË e Festivalit Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"



Teatri "Dodona

Prishtinasit rrëmbyen vëmendjen e spektatorit

Në mbrëmjen e dytë të festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2006" para publikut artdashës dibran u paraqit Teatri "Dodona" nga Prishtina me dramën "Van Gogu Kosovar", të autorit Ilir Muharremi me regji të Hazir Sh. Hazirit, duke i ftuar shikuesit që me një minutë heshtje në respekt dhe në nderim të profesorit dhe aktorit të nderuar mbarëshqiptar Faruk Begolli, që ndërroi jetë ditë më parë.

Kjo dramë, e gërshetuar si një kolazh filmik dhe skenik, nëpërmjet tekstit të shkruar, skenarit, regjisë dhe aktrimit në mënyrë të qëlluar dhe shumë të fuqishme dha një tablo reale dhe trishtuese të jetës kosovare gjatë luftës të vitit 1999, e ilustruar me dhunimet dhe vrasjet serbe në familjet e pafajshme shqiptare. Gjithsesi, ky është një shembull i mirë dhe mesazh i qartë sesi duhet të punojnë krijuesit e artit shqiptar për të zbuluar dhe demaskuar dhunën shtazarake serbe në Kosovë.

Aktorët Alban Makolli, në rolin e Rafaelos, Hazir Sh. Haziri, në rolin e Muslimit, Besnike Arifi, në rolin e studentes, Ilir Muharremi në rolin e doktorit, edhe pse të rinj, luajtën në mënyrë të shkëlqyer, duke dëshmuar pjekuri të padiskutueshme skenike dhe një ardhmëri edhe më të suksesshme.

Hazir Sh. Hazili, regjisor i kësaj drame, pas shfaqjes, për "Faktin", deklaroi se:"

Drama paraqet një artist të ri kosovar, i cili pas dhunimit dhe vrasjes së familjes pëson skizofreni. Pas kësaj krijon realitete dhe karaktere të ndryshme brenda vetes me të cilat diskuton gjatë tërë kohës. Më në fund arrin të zbulohet prej mjekëve dhe të vihet nën përkujdesjen e tyre, pasi skizofrenia është sëmundje e pashërueshme. Vlen të theksohet se raste të këtilla në Kosovë ka shumë, të zbuluara dhe të pazbuluara.

Aktorët, detyrat e tyre të aktrimit i plotësuan me sukses. Ne jemi një ansambël unik dhe me njëri-tjetrin njihemi gati tetë vite. Falenderoj shumë publikun dibran që diti të ndjekë me vëmendje këtë dramë. Është ndjenjë e posaçme të lozësh para këtij publiku të mrekullueshëm».

DITA E TRETË e Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"

Dhimitër Orgocka, mrekulli e skenës

Në ditën e tretë të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007" në ora 18.00, para publikut u paraqit Teatri "A.Z.Çajupi" nga Korça me monologun "Amoku" të Stefan Cvajgut me aktrim dhe regji të Dhimitër Orgockës.

Dhimitër Orgocka, në rolin e aktorit dhe regjisorit, pas shfaqjes na tha se: "Këtë monodramë, si regjisor, e kisha menduar që ta bënte një aktor tjetër dhe ai nuk e bëri. Unë, meqë e kisha dhënë fjalën në Festivalin Ndërkombëtar të monodramës në Kiev, nga turpi që mos u dilja nga fjala, u detyrova ta përgatisja vetë për një kohë të shkurtër. Atje mora çmimin aktori më i mirë. Ardhja në Dibër më vuri në një pozitë tepër të vështirë, sepse kam punuar me aktorët e Dibrës, për popullin dibran, për të cilin ruaj një konsideratë dhe admirim të veçantë dhe nuk desha që ata t'i zhgënjeja. Më thonë se ju ka pëlqyer dhe kjo më gëzon më shumë se në çfarëdo festivali tjetër.

Cvajgu ka një mesazh të çuditshëm dhe të veçantë, ashtu si i ndodhi vetë jeta e tij. Mesazhi i kësaj vepre është të mos jemi hipokritë, gjoja për ta ndihmuar tjetrin. Nëse lind nevoja për ta ndihmuar t'i përkushtohemi ta ndihmojmë gjer në fund, në rast të kundërt lëreni tjetrin të vdesë ashtu si është caktuar, pa e shqetësuar në rrugën e tij



të pakthim".

Prof. Dr. Nebi Islami - kritiku i njohur i skenës, për këtë monodramë u shpreh se: "Kjo monodranë e Cvajgut, e luajtur nga Dhimitër Orgocka, me të vërtetë ishte një ngjarje madhështore, e cila ka mbajtur me një frymë jo vetëm publikun, por dhe të gjithë njohësit e artit e të aktrimit. Nga një temë në dukje krejt e thjeshtë, nga një ngjarje aksidentale e një aristokrateje që mbetet shtatzënë në mungesë të bashkëshortit, shndërrohet menjëherë në një dramë të madhe njerëzore, e cila e sfidon shpirtin e njeriut të personifikuar në një mjek që ndjen peshën e përgjegjësisë për mosshpëtimin e saj dhe hap probleme tjera filozofike, teologjike, religjioze, duke stigmatizuar hipokrizinë e krishterimit të fshehur nën maskën e shenjtërisë së jetës bashkëshortore, e cila doemos në pasionin njerëzor thyhet dhe mandej mbetet në mëshirën e fatit dhe e meriton sipas kësaj ideologjie edhe vdekjen. Dhimitër Orgocka me fjalën e tij artistike, me gjestet dhe lëvizjet, me lëvizjen e syve, duarve, këmbëve, trupit, të mizanskenimit, të diksionit aq të pastër dhe aq të mrekullueshëm krijoi një atmosferë madhështore, e cila me të vërtetë është për t'u mahnitur dhe është për t'u himnizuar, që rrallë e shohim në skenat e hapësirës shqiptare. Unë jam tejet i mrekulluar nga një rol i tillë, nga përmbajtja e tillë. Mendoj se veprat e tilla të mëdha jo vetëm që e kënaqin publikun, por krijojnë gjurmë në shpirtin e njeriut, ndërgjegjen dhe vetëdijen kombëtare, sepse janë aq universale, sa edhe individuale dhe kombëtare. Kjo monodramë është njëra nga evenimentet më të fuqishme të gjertanishme në festival. Mendoj se edhe në skenën shqiptare është një uverturë e shpalosjes se vlerave të monodramës".

DITA E TRETË e Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"

Kumanovarët kënaqën publikun



Në shfaqjen e dytë, në ditën e tretë të këtij festivali, në ora 21.00, para artdashësve dibranë u paraqit Teatri «Ultra» nga Kumanova me komedinë «Stjuardesat» të autorit Mark Komolec, me regji të Sejfedin Nuredinit.

Aktorët Qazmedin Nuredini, në rolin e Bernardit, Mentor Nuredini, në rolin e Robertit, Aida Alidema, në rolin e Zhaklinës - stjuardesës franceze, Zarije Jonuzi, në rolin e Zhanetës - stjuardesës amerikane, Mirlinda Sahiti, në rolin e Juditës - stjuardesës gjermane dhe Sefedin Shabani, në rolin e Bertit - shërbyesit, me një talent, angazhim dhe gjendshmëri skenike arritën t'i ofrojnë një kënaqësi artistike profesioniste publikut, gjë që u dëshmua edhe me duartrokitje.

Regjisori Sejfedin Nuredini pas shfaqjes deklaroi se: "Ndërrimi i skenës dhe i hapësirës me siguri që ndikoi edhe në lojën e aktorëve. Pas premierës më shtatë gusht, ne kemi pasur një pushim të madh. Megjithatë, këto djelmosha dhe vajza i kryen detyrat e veta dhe ia dolën që atë që e arritëm gjatë provave, ta sjellim edhe në skenën e Dibrës.

Në këtë komedi bëhet fjalë për devijimet që ndodhin në një shoqëri nga individë të caktuar dhe në mjedise të caktuara. Këtu kemi një personazh që nuk do të martohet, por që dëshiron të ketë tre të fejuara, kemi një lloj poligamie me të jetuarit me më shumë femra, si shprehje e sedrës së mashkullit. Por, ja, që gjithnjë meshkujve nuk u shkon kungulli mbi ujë. Kjo komedi arriti qëllimin, duke përqeshur gjërat që nuk janë normale. Publiku dibran, si gjithnjë, na ka pritur dhe vlerësuar mirë».

DITA E KATËRT e Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni -Dibra 2007"



Dëshmi e studentëve të talentuar tiranas

Në ditën e katërt të këtij festivali, në ora 18.00, para artdashësve u paraqitën studentët e Fakultetit të Artit Skenik nga Tirana me performancën "Mirë apo keq".

Këta studentë të rinj, me tematikat e zgjedhura që nga "Luli i vocërr" i Migjenit me tullumbacet e tij, pastaj me lojërat e të rinjve, pengesat e prindërve, smogun e padurueshëm të Tiranës e deri të përralla me rrepën, i dhanë skenës një freski përmbajtësore rinore.

Donila Kapidani, regjisorja e kësaj performanse, pas shfaqjes u shpreh se: "Janë një grup studentësh nga viti i parë dhe i dytë në degën e regjisurës të Fakultetit të Artit Skenik në Akademinë e Arteve në Tiranë. Kjo është shfaqja e tretë para publikut dhe sipas meje aktorët e rinj i kanë përmbushur të gjitha objektivat.

Kjo tregon punën që bëjnë në vitin e parë dhe të dytë, jo vetëm si program mësimor, por jemi munduar të bëjmë një performansë, e cila pas provimeve të shfaqet para publikut. Ky është një eksperiment i ri që ka filluar Akademia e Arteve këtyre dy viteve të fundit.

Mesazhi i kësaj pjese është: Zot, na ndihmo të duam, të na duan dhe të dimë të mbajmë atë që duam.

DITA E PESTË e Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"

Tetovarët interpretuan role gjigantësh



Në ditën e pestë të këtij festivali, para artdashësve dibranë u paraqit Fakultetit i Artit të Dramës pranë USHT-së, së bashku me Teatrin e Tetovës, me dramën: "Duke pritur Godonë", të autorit Samuel Beket dhe me regji të Senad Abdulit.

Aktorët Altrim Mahmudi, në rolin e Vladimirit, Arsim Fazliu në rolin e Pocos, Bekim Jahiu në rolin e Lukit dhe Elmir Sejfullai në rolin e Astragonit, gjatë tërë shfaqjes dëshmuan një angazhim dhe profesionalizëm maksimal për moshën e tyre, duke qenë sovranë të sallës së mbushur përplot me shikues.

Senad Abduli, regjisor, pas shfaqjes, u shpreh se: "Kjo shfaqje është jashtëzakonisht e rëndë. Kemi vënë në skenë një kryevepër botërore, me djem të rinj. Edhe pse kjo përbënte një vështirësi jashtëzakonisht të madhe, mendoj se këta aktorë realizuan me përpikmëri detyrat e përcaktuara. Aktorët sonte dhanë maksimumin e tyre. Unë publikut dibran i ofrova një shfaqje të niveleve botërore. Mesazhi i Godosë është i vjetër, po aq sa është edhe njerëzimi. Pritja, klithja dhe ankthi për një të ardhme më të mirë ekziston gjithmonë. Godoja në Tetovë është nisur me një qëllim që këta aktorë ta realizojnë synimin e tyre. Që shqiptarët e Maqedonisë të fillojnë të organizohen në mënyrë institucionale. Në fakt, Godoja erdhi në Tetovë, u themelua Teatri dhe u zyrtarizua Fakulteti i Artit Dramatik. Godonë shpresojmë që ta sjellim edhe në Dibër".

MBRËMJA E GJASHTË e Festivalit "Teatri Kombëtar në Maqedoni - Dibra 2007"

Gjilanasit freskuan skenën dhe publikun




Në mbrëmjen e gjashtë të këtij festivali para artdashësve dibranë u paraqit Teatri Kombëtar i Gjilanit me dramën "Gomari diversant", të autorit Jeton Neziraj dhe me regji të Jeton Ahmetajt.

Aktorët Jashar Shahiqi në rolin e Metës, Veton Osmani në rolin e komandirit jugosllav, Muharrem Sulejmani në rolin e komandirit shqiptar, Naser Zyberi në rolin e mësuesit, Flutura Zeneli në rolin e Bukuries, Ali Demi në rolin e Lilushit, Gyner Halili në rolin e ushtarit shqiptar, Alban Shahiqi në rolin e ushtarit jugosllav, Bukurie Kçiku në rolin e Lilushes, Mejreme Berisha në rolin e fshatares, Nuhi Matoshi në rolin e fshatarit dhe Kenan Gurgurovci në rolin e fshatarit, luajtën në mënyrë të mrekullueshme dhe sollën freski në skenë dhe te spektatorët, të cilët i duartrokitën shumë herë. Me një plasticitet romantik dhe real, të shoqëruar me muzikë dhe kostumografi, ata sollën situatën e gjendjes kufitare në kohën e monizmit me tërë pikanterinë e saj, kur në Shqipëri sundonte diktatura e Enver Hoxhës, ndërsa në Jugosllavi diktatura e Titos.

Jeton Ahmetaj, regjisor, pas kësaj shfaqje, deklaroi se: "Kjo shfaqje është bërë më herët dhe ka pasur një pauzë relative. Çdo gjë ka qenë korrekte, si nga ana organizative dhe kreative. Jam i kënaqur edhe nga loja e aktorëve. Publiku dibran është një befasi e këndshme për mua dhe kësi publik i mrekullueshëm rrallë gjendet në trojet tona shqiptare".

"Periudha të cilës i referohet kjo shfaqje është shumë e kapshme për publikun dhe sidomos për publikun dibran, i cili ka jetuar dhe jeton në një zonë ndërkufitare. Është një tragjedi që është parë nga ana komike prej autorit të tekstit dhe prej anës së përgjithshme".

Një libër i veçantë i dhimbjes njerëzore



Kur të takon të takosh diçka nga shokët dhe miqtë e dikurshëm nuk duhet të habitesh, por duhet të kënaqesh dhe të ndihesh mirë se askush nuk po të garon, (edhe po të garoi mirë bën), por po të flet hapur me gjuhën e zemrës. Kështu ndodhi edhe me mua kur lexova poezitë e Hasan Mihës, ish kolegut tim ushtarak tani në emigracion.

Uroi që të gjithë t'i lexojnë e t'i kuptojnë këto vargje të dhimbjes njerëzore. Unë, si poet dhe si gazetar ushtarak, ndoshta e kuptoi me mirë Hasanin, sepse ia njoh pulsin, ia njoh dhimbjen, ia njoh punën dhe mbi të gjitha edhe si bashkëkohës ia njoh shqetësimin.

Si prind e di çdo të thotë të aksidentohet një fëmijë, aq më tepër nga armët. Si ushtarak ia njoh vuajtjet, të cilat mund të krahasohen me ato të minatorëve të cilët futeshin në minierë dhe nuk diheshin a do të dilnin në sipërfaqe dhe me ato të përndjekurve të cilët nuk shikonin të dashurit veç se me leje nga autoritetet. Si poet dhe si publicist e di se si ndjehesh kur fjala jote nuk arrin në veshin e duhur, prandaj pajtohem me protestën tënde ndaj padrejtësive. Këto vargje të dhimbjes njerëzore dhe kjo analizë vetmitare nuk janë bërë siç e thashë në fillim për t'u renditur në radhët e krijuesve, megjithëse ato kanë tharmin e tyre, se mbi të gjitha janë të vërteta dhe të jetuara, janë fjalë zemre.

Në vargjet tuaja çdo shqiptar la diçka të veten, ndaj mendova dhe besova se bëhet mirë të shtohet dhe ky libër në bibliotekat e shqiptarëve dhe do të kënaqesha ta lexonin me shumë të rinjtë.

Edhe në pesimizmin, mosbesimin dhe ashpërsinë herë-herë të vargjeve ka rreze drite që ndriçojnë shpresën se Shqipëria do të bëhet një ditë dhe më e bukur dhe më e begatë, një vend dinjitoz i Europës.

SAKIP CAMI

DITA E SHTATË e Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007"

Vlonjatët me cilësi të lartë aktrimi



Në ditë e shtatë të Festivalit "Teatri Shqiptar në Maqedoni - Dibra 2007:, në shfaqjen e orës 18.00, në skenë u paraqit Teatri "Petro Marko" i Vlorës, me dramën "Rëndësia e të quajturit i ndershëm" nga Oscar Willde, me regji të Roland Mingës.

Aktorët Vladimir Habilaj në rolin e Xhek Worting, Astrit Mamaj në rolin e Algernon Monkrif, Desantila Kristo në rolin e Guendolen Fairfaks, Eliona Thomaraj në rolin e Sesilia Kardiu, Eli Veizi në rolin e Ledi Brakenuell, Vasillaq Goda në rolin e Kasubel, Ilirian Ali në rolin e Z. Prizm dhe Artan Islaminë rolin e Lein Meriman, pasqyruan një dinamizëm skenik plot suptilitet me vlera të larta aktrimi, duke u dhuruar shikuesve mundësinë e përjetimit të skenave çlodhëse.

Roland Minga, regjisor i kësaj komedie, pas shfaqjes, u shpreh se: "Ne, viteve të kaluara, në Dibër kemi dhënë disa shfaqje. Te spektatori dibran ka një veçanti, ka një veti që nuk e kanë spektatorët në vendet e tjera. Këtu spektatori nuk është vetëm thjesht për të mbushur sallën, por ai ndjek në mënyrë shumë inteligjente shfaqjen, reagon dhe ka fleksibilitet nga një moment i shfaqjes në tjetrin, duke e kuptuar dhe perceptuar shfaqjen ashtu siç serviret ajo. Në momentin që kjo merret nga spektatori, do të thotë se aktorët e kanë bërë detyrën e tyre. Publiku bashkëjetoi me shfaqjen dhe me mesazhin: "Çdo gjë që shkëlqen nuk është flori". Nga ajo që ka shkruar autori, unë e kam bërë në mënyrë shumë të këndshme, diçka mes satirës, lojës dhe të qeshurit".

Durrsakët mrekulluan skenën



Në shfaqjen e dytë të ditës së shtatë të këtij festivali në ora 21.00, para artdashësve u paraqit Teatri "Aleksandër Mojsiu" i Durrësit me dramën "Vajza pa prikë" të autorit A.N.Ostrovski, me regji të Driada Dervishit.

Aktorët Enkela Braho në rolin e Larisa Dmitrijevna, Dritan Borici në rolin e Juli Kapitoniç Karandishev, Sanie Hoti në rolin e Harita Ignatievna Ogudallova, Saimir Braho në rolin e Sergei Sergeiç Paratov, Hysen Bashhysa në rolin e Moki Parmeniç Knurov, Xhelal Tafaj në rolin e Vasili Daniliç Vozhevatov, Roland Koca në rolin e Ivanit, Muharrem Hoxha në rolin e Gavrilit, Marvin Tafaj në rolin e Cirkovit, Bledi Rudi në rolin e ciganit dhe Brixhilda Arapi në rolin e ciganes, u mishëruan me publikun nëpërmjet aktrimit të mrekullueshëm dhe në sallën e mbushur me afër një mijë spektatorë, zotëronte asi qetësie dhe vëmendje që mund ta kishte lakmi çdo podium skenik.

Regjisorja Driada Dervishi, pas shfaqjes, deklaroi se: "Mikpritja dhe ngrohtësia e publikut dibran arriti që t'i bënte aktorët të ndihen mjaft mirë, të sigurt në vetvete dhe dhanë më të mirën e tyre. Më të ngrohtë se publiku dibran nuk gjen as në Shqipëri, por as në vendet e tjera ku kemi shkuar. Mesazhi i kësaj drame them se është shumë aktual. Ata që e shohin e kuptojnë se jetojmë në një shoqëri ku paraja është bërë zot dhe njerëzit i kanë lënë të gjitha ndjenjat, dëshirat që kanë, dashurinë e pastër e kanë harruar dhe po shkojnë drejt materiales. Ndaj porosia është: Mos shkoni drejt materiales, se ka gjëra me më shumë vlerë se paraja".

“Ne, dibranët, duhet të bëjmë më shumë për Dibrën”

Sapo futesh në rrugën “Myslim Keta”, ende pa vajtur tek “Kafja e Rremës”, në anën e majtë të rrugës, ndriçon që larg një tabelë e madhe, shkruar bukur; Market “Rruga e Arbërit”. Në të gjithë këto lokale, kjo është e vetmja tabelë që ka zgjuar kureshtjen dhe tek kalimtarët e shumtë. Me pronarin e këtij marketi nuk e kishim të vështirë për t’u takuar. Ishte nga Dibra dhe u lidhëm me të në telefon. Lamë takimin në lokalin tjetër ngjitur, i cili kishte një emër tamam shqip “Pëllumbat e paqes”.

Fatmir Kurti, pronari i këtij lokali erdhi shpejt. Megjithëse i kishte kaluar të dyzetat, tregonte më i ri në moshë.

- Edhe pse ekonomia e tregut ishte legalizuar në vendin tonë,- tregon Fatmiri, - unë atëherë u bashkova me shqiptarët e shumtë që kërkonin një jetë më të mirë jashtë kufijve të vendit. E braktisa punën si arsimtar dhe kalova në Greqi. Kam punuar në punë të ndryshme, deri në fund të vitit 1993. Në këtë biznes u futa vonë, vetëm atëherë kur vendosa përfundimisht të shkëputesha nga Dibra dhe të vija me banim në Tiranë.

Në fillim blemë një ndërtesë të vjetër, - tregon Fatmiri, - pastaj filluam të ristrukturojmë këtë ndërtesë dhe shumë shpejt ia arrita qëllimit. Arrita atë që desha, realizova një ëndërr timen të kahershme, qysh kur punoja emigrant në Greqi. E sot, vërtet, lokali “Pëllumbat e paqes” në rrugën “Myslim Këta” është më i miri.

- Zakonisht shërbejmë për dasma dhe gëzime familjare - thotë Fatmiri- dhe ato prenotohen edhe një vit më parë. Çdo vit mund të organizohen mbi 200 dasma.

E veçanta e këtyre dasmave tek ne është se çiftet që kryejnë ceremoninë e dasmës në lokalin tonë i ftojmë më datë 21 dhjetor në një mbrëmje të përbashkët, ku çdo gjë është gratis nga vetë lokali. Po aktiviteti i Fatmir Kurtit nuk është vetëm ky lokal që së shumti shërben vetëm për dasma. Marketi me një sipërfaqe të madhe dhe me mjaft artikuj të ndryshëm plotëson nevojat për produkte ushqimore dhe detergjente të gjithë banorëve të kësaj zone. Dhe Fatmiri e dinte fare mirë se pikërisht këtej, në një kohë jo shumë të largët do të kalojë ajo që në media dhe popull ka filluar të quhet “Rruga e Arbërit”. Ndaj dhe marketit i vuri pikërisht këtë emër. Tabela tashmë ndriçon që larg dhe shpeshherë ndalojnë dhe udhëtarë të ndryshëm e pyesin me kërshëri për këtë emërtesë. Fakt është se marketi rri plot në çdo orë të ditës. Jo për emërtesën që ka vënë pronari, por për shërbimin, komunikimin me klientët dhe konkurrencën e çmimeve, të cilat janë më të lira në të gjithë zonën. Biznesin tashmë e ka shtrirë dhe më gjerë. Duke pasur vëllezërit me profesion inxhinierë janë futur bashkë në fushën e ndërtimit. Pas ndërtimit të disa apartamenteve banimi në Durrës, tashmë kanë blerë tokë në Paskuqan.

JETA

Fatmir Kurti ka lindur në Luzni të Dibrës më 25 shtator 1965, ku pikërisht tashmë ka dhe përvjetorin e lindjes. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i mbaroi në fshatin e lindjes, kurse shkollën e mesme të përgjithshme në qytetin e Peshkopisë. Shkollën e lartë e përfundoi në Shkodër për matematikë-fizikë, si dhe më vonë u specializua 6 muaj në Tiranë. Ka punuar mësues në Selishtë e Luzni dhe në fund drejtor shkolle në Luzni. Mbur-ret Fatmiri me të drejtë me të parët e tij. Jemi ndoshta nga familjet e pakta që për disa vite me radhë nuk kemi pasur hasmëri me njeri qoftë në fshat, por dhe jashtë tij. Ndaj dhe emrin e lokalit këtu ia vumë emrin “Pëllumbat e paqes”. Paqe mes njëri-tjetrit, se vetëm atëherë edhe komuniteti dibran që jeton prej vitesh në metropolin shqiptar bëhet faktor jo vetëm në jetën e përditshme, por dhe në politikë. Fatmiri rrjedh nga një familje intelektuale. Jo vetëm vetë, por dhe vëllezërit e tij të gjithë janë arsimuar. Kështu, Shehati ka mbaruar fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit, Musai inxhinier gjeolog, Bazriu inxhinier mekanik.



Një familje e madhe intelektuale, që jeton dhe punon në Tiranë, por që është e lidhur ngushtë me Dibrën, vendlindjen e tyre.

- Kemi një projekt të veçantë, - thotë Fatmiri bashkë me vëllezërit. Projektin e kemi përfunduar dhe sipër do të shkruajmë “Kurora e Dibrës”. I gjithë ky projekt vërtet ambicioz ka mbetur thjesht për arsye burokratike nga komuna e Babrrusë se ne kishim filluar me kohë nga zbatimi.

Nostalgjik për vendlindjen

Fatmir Kurti flet me mall dhe dashuri për vendlindjen dhe është tepër nostalgjik për atë vend të bukur që natyra u ka falur vetëm dibranëve.

- Edhe pse kemi ardhur në Tiranë, nuk duhet ta braktisim Dibrën, por t’i kthejmë sytë shpesh andej nga erdhëm, ku u lindëm dhe u rritëm. Na takon ne dibranëve të bëjmë diçka për Dibrën, pastaj të kërkojmë dhe nga shteti. Rrugën e Arbërit që sot falë dibranëve është bërë mjaft e lakuar dhe mediatike, të parët tanë e kanë shkelur herët më këmbë dhe me karvane. Gjyshi na tregonte se ka pasur njerëz që e kanë bërë dhe brenda ditës këtë rrugë nga Luznia deri në Tiranë. Kjo ishte zgjidhja që kishin bërë të parët tanë si rruga më e shkurtër për të bërë tregti atëherë në Tiranë. Nëpër këtë rrugë ka kaluar dhe heroi ynë kombëtar Skënderbeu. Është ndoshta një nga rrugët më të vjetra në vend pas asaj Egnatia. Në radhë të parë duhet të ngrihemi ne e ta kërkojmë me forcë këtë rrugë që nuk shërben vetëm për Dibrën dhe dibranët, por dhe më gjerë. Nuk duhet t’i lëmë politikanët tanë të çirren nëpër podiume në fushata elektorale dhe të na hedhin hi syve se gjoja do të ndërtojnë këtë projekt, i cili është dhe korridori lindjeperëndim. Qoftë dhe bizneset e dibranëve të bashkohen dhe me kontribut të të gjithëve ky projekt madhor duhet të realizohet. Atëherë binden të gjithë se dibranët kur janë bashkë bëjnë gjithmonë punë të mira. Këtë e kemi provuar dhe më parë. Komuniteti dibran sot në metropol është më i madhi. Qysh në vitet 1912-1913 kur filluan reprezaljet e para serbe karshi popullsisë dibrane, popului i Tiranës hapi portat. E sot ende shprehen vetë tiranasit e vjetër:

-Mburremi që kemi një mik apo komshi një dibran. Përse t’i humbasim pra ato vlera që i kemi trashëguar vite më parë. Fatmiri kudo, në çdo mjedis pune, mban flamurin kuq e zi, edhe në një foto pasaporte flamuri qëndron sipër. Në qoftë se nuk do të bëjmë ne për kombin, - thotë ai, - nuk kemi pse të presim nga të tjerët.

Shaqir Skarra



Profesor Ibrahim Egriu, njeriu që e ngriti lart emrin e Dibrës dhe në vendet skandinave

Nga **OSMAN XHILI**



Ibrahim Egriu

Të shkruash për profesorin e nderuar Ibrahim Egriu është sa e lehtë, aq dhe e vështirë, sepse jeta e tij është e ngjeshur me një aktivitet të begatë arsimdashës e patriot. E vështirë, sepse nuk mundesh të pasqyrosh gjithë këtë material brenda kornizave të një shkrimi apo emisioni televiziv.

Lindi më 1939 në Maqellarë të Dibrës, vit që përkon me pushtimin fashist të Shqipërisë. Ishte ky një mesazh i qartë se jeta e tij do të ishte përherë e trazuar e ai si një skaf i shpejtë do të kapërcente në shpinë të dallgëve për të arritur bregun. Kombi i tij rënkonte. I ndarë e i copëtuar në disa shtete: Zemra në Tiranë, gjymtyrët në Prishtinë e deri në Shkup, degë të tjera në Europë e botë. Ibrahimi i ri e kuptonte se për të kryer misionin e tij duhet të ishte i ditur dhe këtë dituri t’ua jepje më pas të tjerëve. Mbaroi arsimin e mesëm e më pas të lartë për gjuhë dhe letërsi. Jo më kot e zgjodhi këtë degë, pasi gjuha e leximi për momentin ishin më të rëndësishmit. Ky komb duhej të kultivonte e mbante gjallë gjuhën e tij e vetëm përmes saj të mbijetonte. Profesori, atëherë i ri, u dashurua me dramën. Kjo gjini mund t’i jepte mundësi për t’i dhënë popullit të tij mesazhe se makina e vjetër luftarake po jepte shpirt.

Viti 1979. Katër drama të vëna në skenë, katër drama që tronditën jetën intelektuale të Shkupit. Kishte në to fllad, kishte revoltë, jetë, lot e shpresë. Të tilla ndjenja provokuan dramat e Ibrahimit që tashmë kishte filluar të piqej. Por makina luftarake nuk mund të lejonte gjëra të tilla t’i kalonin nën hundë. Ajo do të ishte një shkatërrim për të. Ibrahimi e nuhati atë ç’po gatuhej rreth tij. Një tjetër furtunë do të frynte e kosiste intelektualët shqiptarë. Ai nuk do t’ia lejonte vetes të plasej në burg. Nata e tmerrshme e vitit të ri 1969 ishte akoma e freskët në kujtesën e tij. Iku në Zvicër e më pas në Suedi. Iku atje ku fjala është e lirë, ku fjalën nuk e prangosin. Iku me një brengë në zemër, por dhe me një përkushtim. Ndoshta akoma më shumë do t’i jepte çështjes shqiptare, do t’i jepte trupin dhe shpirtin e tij. Më 5 maj 1986 hapet në Suedi radioja e parë shqiptare, ku Ibrahimi ishte truri i saj. Ishte redaktori, regjisori, gazetari, ndërlidhësi.

Net të tëra, - kujton profesori, - e gdhinim në një divan të thjeshtë aty në studio. Pinim kafe e harronim shpesh të hanim dhe bukë. Por, sidoqoftë, pas viteve ‘90 çështja shqiptare do të diskutohej në shumë tryeza të politikës botërore. Ishin vite të vështira por shpresëdhënëse. Dhuna e represioni ndaj shqiptarëve bëjnë që të largohen vetëm në Suedi rreth 60 000 veta. Kush do t’i dallonte këto njerëz më pas se janë shqiptarë, po të mos ishte gjuha? Kjo pyetje vërtitej pa pushim në kokën e profesor Ibrahimit e kolegëve të tjerë. Përpjekjet e tyre spontane duheshin organizuar në një shkallë më të lartë, më efektive. Më 30 maj 1992 krijohet LASH (Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë). Nuk ishte thjesht një emër, një organizatë fantazmë. Ishte një staf pune me 266 pedagogë që mësuan pa fare shpërblim 7200 nxënës në 72 kampe anembanë Suedisë. Madje, si të mos mjaftonte kjo, tekstet shkollore duhej t’i hartonin vetë. Dhe shumë shpejt nxënësit mbanin në duar gramatikën shqip-suedisht, antologji, histori, gjeografi e plot të tjera. A mund t’i harrojnë këta nxënës vite më vonë mësuesit e tyre, këta heronj që ditën t’ju sjellin dritën, kur ajo po mekej, që u mbollën krenarinë e të qenit shqiptar, kur atë po e hidhnin si një maskë pa vlerë? Me siguri jo. Emrat e tyre janë gdhendur në botën e të gjallëve.

7000 mijë shqiptarë mbahen në burgjet serbe. Ata kërkojnë për avokat mbrojtës popullin shqiptar, atë që i lindi dhe rriti këta trima. Zëri i Ibrahimit bashkohet me atë të shqiptarëve të tjerë për të sensibilizuar organizma vendimmarrës në botë. Ai bashkon jo thjeshtë zërin, jo thjeshtë pendën e tij të mprehtë, por shumë më tepër. Bëhet organizator i dy grevave të urisë në Malmoe. Natën e vitit të ri 2000, kur njerëzit hanin e pinin, profesori me shokë luftonte mes jetës dhe vdekjes. E çfarë mund të jepte profesor Egriu më shumë se jetën e tij? Por jeta i duhej akoma, se punë të tjera të mëdha e prisnin përpara. 26-27 nëntor 2001, në Prizrenin historik, në Prizrenin e kuvendeve të mëdha mblidhet Lidhja Shqiptare Botërore. 1600 delegatë që nga Australia e largët, Amerika, Europa e nga trojet amtare, miratuan njëzëri platformën e bashkimit kombëtar në paqe e për paqe.

Të forcohet uniteti kombëtar e të kërkohen të drejtat e liritë e nëpërkëmbura shqiptare. Fjala e kryetarit Kuzhini pasohet nga shumë të tjerë. Profesor Egriu vinte me cilësinë e kryetarit të LSHB-së për vendet skandinave, si dhe ishte në kryesinë e punës së kongresit.

(Vijon në faqen 10)

Naim Plaku dhe “Këngët e Korabit”



Dr. Fejzulla Gjabri*



Në një vëllim të Naim Plakut “Fllad e frullizë”, shkëpus një fjali: “Ndoshta e ka dëgjuar një zë që dridhet e këputet në telat e çiftelisë nga një pendë pëllumbi, në ofshamat e fyellit apo ligjërimet e lahutës, që mëçojnë zanat e malit nga gjumi”. Një korrigjim mund të bëja: Poeti popullor Naim Plaku vetëm se “nuk u këput”, se për t’u dridhur sa të duash”.

Ashtu i qetë, si shumica e poetëve popullorë, me hallet historike dhe të kohës së re, vuajti shpirtërisht. Vuajtja fizike është e rëndë, po më e rëndë është vuajtja shpirtërore. Dhe Naimi ka një veçori: Diti ta përballojë dhimbjen shpirtërore pa rënkime, pa ankime. Jo se s’dinte të ankohej, po kujt se? Në hyrjen e vëllimit të sipërpërmendur, konstaton: “Tek qoshja ku isha futur, nga ajo dritarja e vogël e shtëpisë në fshat, vështroja mëngjeset e bukura të qullura me vesë dhe mbrëmjet e trishtuara që laheshin me dritën e verdhë të hënës. Shikoja rrëketë...”. Kontraste natyre që ngjasonin me kontraste shoqërore: “...gërryenin pareshtur ... zemrën e plakur...”. Prapë me të gjallët: “Hynin dhe zogj e lule, pranvera me borë të bardhë e dimra me cingërima, djepe të përmbysur e shtretër nusesh të lagura më psherëtima”. Ja, këto mendime të qeta e shpesh kryengritëse ashtu në heshtje, pra, vetëm në shpirt, me ofshamën e fyellit, ofshan dhe poeti popullor, Naim Plaku.

Ata që pak njohin Naim Plakun, po u themi që në fillim se mund të kenë dëgjuar këngën “O, prite Azem Galicën”, kënduar në vitet ’80-të. Është teksti i Naim Plakut, që e këndon Arif Vladi. Kur dëgjonim zërin e bukur të këngëtareve Cahje Poleshit, Liri Rashës e të tjerë këngëtarë dibranë, shumë pak e dinin se prapa tyre ishte poezia e Naim Plakut. U thuri vargje figurave historike, Drinit plak, Korabit etj. I qetë, “i urtë” (në thonjëza se ashtu ishte puna), por poet. Ndoshta nuk duhet thënë më.

Cikli “Këngët e Korabit”

Rreth e qark Korabit ka jetë njerëzore. Naim Plaku i ka “prekur” vetë këto anë. Në një shkrim para këtij numri të gazetës “Rruga e Arbërit”, me të drejtë konstaton se është “Një cikël i veçantë i lirikave popullore të këngëve të mërgimit, dashurisë dhe natyrës”. Unë mund të them se është një poemë që i ka të gjitha këto tema, në qendër të cilës qëndron dashuria njerëzore. Aty është malli për njeriun e larguar nga shtëpia, është natyra, bagëtia, meraku etj. Pra, cikël më vete.

Parë në këndin e formës, shumica përfundojnë me ofshamë –oj, -moj, e mjera on-o, etj, e vënë në pah më shumë se në çdo këngë te kënga “Moj Fusha e Korabit”.

Në një vëzhgim më të hollësishëm, duket se shumica e këngëve te cikli “Këngët e Korabit” lidhen me këngën “Moj Fusha e Korabit”. Gjithsesi, dhimbje. Vetë fyelli që i shoqëron këto këngë e shpreh bukur dhimbjen. Ndoshta një lidhje folklorike mbarëshqiptare. Pikërisht se kjo është ndier edhe në festivale, na lejon të themi se dhimbja në viset shqiptare ka “detyruar” që ta nxjerrin “të keqen” me këngë, ta publikojnë atë, për të lehtësuar sadopak veten.

Pak nga gjeografia e dhimbjes në këngë

Ta shohim pak si është shpërndarë në viset tona *dhimbja e largimit nga shtëpia.* Duket se dhimbja e largimit të burrit nga shtëpia, si dhimbje shpirtërore, ndjehet si nga ai që largohet edhe ajo që e përcjell. Temë aq e hershme kjo, sa jeta vetë. Prapë te Mitko: “Vanë çunat, vanë,/ vanë në kurbet, /mbenë çupat, mbenë,/ në dyert e t’et.” Dhe më poshtë: “Janë dy kunata,/ duhen posi motra,/ faqet e kuqe,/seç ua puthin bota”. Meraku i çunave depërton deri në imtësi dashurore, e cila shfaqet haptas me çiltërsi. Po ky merak, po tashmë nga femra, shfaqet hapur te kënga e njohur “Fusha e Korabit”: “Shkuen djemt e ri,/ lanë ogjaqet n’zi,/ shkuen, posi shkuen,/ shkinat do t’na i duen”.

Edhe nëna nuk mbetet pa lot në këngë. Në një krijim, siç duket më i vonë dhe i kënduar në Fest 2000 nga grupi folklorik i Lushnjes, thuhet: “Lash fëmitë, lash shtëpinë,/ për të shkretën varfëri,/ Mbeti nëna me lot në sy”. Këto vargje janë vënë pas vargut “Mora rrugën për Janinë”, varg ky i njohur i folklorit tonë. Po në Fest-Gjirokastër 2000, Librazhdi solli një variant të “Fushës së Korabit ose e përafërt më të, pasi motra përcjell vëllanë larg shtëpisë: Kur vajta në shpi,/ lotët m’shkojshin shi,/ kur ngrita dyshekun,/ të gjeta qostekun”.

Ne Fest-Gjirokastër ’88 Lushnja këndoi një këngë, që për nga ndërrimi i poezisë ngjan me baladën e dhimbshme të “Mbeçë, more shokë, mbeçë”. Tri vargje të saj: “Dallëndyshe, moj krahëshkruar,/Thuaj nënës, djali të është martuar,/ me tre plumba në krahëruar...”. Po në ketë Festival Shkodra solli: Lajnë dy vasha në krue,/Njana lante,/tjetra kjante,/Djali m’iku e s’vjen ma kurrë,/mi kry i kanë vu nji gur”. Mati në ketë festival solli një këngë të dhimbshme nga Kurdaria: Ka nisë qyqja me vajtue,/ Ka nisë guri me me u shkrumue, /Ka nisë kroi me me u shterrue,/ Me lot bukën tuj gatue./ Prita burrin larg harrue,/ Prita un’e priti djali,/kurkund s’i gjindet vorri”.

Festivali i ‘88-ës dallohet për këngët e dhimbshme. Thuajse çdo grup ka sjellë nga një të tillë krijim. Nga Bërzheshta e Librazhdit vargjet e një kënge sjellin forcën e njeriut për të përballuar largimin e njeriut të dashur nga shtëpia. Duket se duke u mbështetur te e kaluara, sikur parashikojnë eksodet e 2-3 viteve pasardhëse. Në këtë këngë, me titull “Lotët e kurbetit”, thuhet: “I ra djepit e duroi,/ i ra gurit e thërmoi,/ i ra malit, e anoi,/ Ç’mi ra zemrës,/ zemra e duroi”. Citova këto vargje nga këngë të ndryshme në vise të ndryshme shqiptare, për të dalë te “Cikli i Këngëve të Korabit”, të trajtuara me forcë argumentuese nga Naim Plaku. Jehona e dhimbjes shpirtërore, ngado që të vijë, është e pranishme në krijimtarinë e folklorit tonë.

Lirika shoqërore të mërgimit ekonomik

Të gjitha këngët aty sillen. Tisi erotik, - siç thotë Naim Plaku, - ndjehet këndshëm në vargje. Ky tis thellon dhimbjen shpirtërore në mjedise ku drejtpërdrejt nuk thuhet. Ajo nuse që pret burrin, ajo vajzë që pret të dashurin, vetëm brenda dhomës derdh lot. Në sytë e të tjerëve ishte (dhe aty edhe është tabu). Vetëm kënga ka të drejtën të ta japë erotikën ashtu troç: “Moj Fusha e Korabit,/.../, ti na dave shtratit,/...”. Në farë mënyre kënga lehtëson shpirtra të brengosur me muaj, të mbyllur në dhoma dimri, që mezi presin Shëngjergjin. “Kur t’na vij Shëngjergji,/ Vjen i majri e i keçi”, thotë një varg nga “Këngët e Korabit”. Kurbeti ka ndarë nëna me djem, nuse me dhëndër. Ndodhitë kthehen shpejt në merak. Secilit i shkon mendja te vetja. Nënës që s’ka marrë lajm për djalin i shkon mendja te e keqja dhe shprehet më vargje që herë i dëgjon dikush e herë s’i dëgjon. Nusja e re që “asht da shtratit”, kujton edhe ajo për çastin e ardhjes. Por, para këtij çasti, mendja i shkon te “do na i duen shkinat”, një dyshim bashkëshortor vetëm në mendje, vetëm në këngë. Se kënga ka liri të tillë, ndryshe, po ta thoje në mjedis shoqëror, jashtë këngës, vlera do të kthehej në antivlerë, në zënie e grindje.

Lirikat shoqërore “Këngët e Korabit”, duke pasur bërthamë këngën “Fusha e Korabit”, mërgimi në të shumtën e herës, dalin me karakter të mërgimit blegtoral. Pra, bagëtia i detyron që gjashtë muaj të jenë në bjeshkët e veta në Korab, gjashtë muaj të tjerë në vise të ngrohta, por larg familjes, si në Selanik apo tash vonë edhe në Tiranë etj.

Në analizën e “Këngëve të Korabit” Naim Plaku arrin të shprehë edhe vetë ndjenja. Ndjenja që marrin udhë te këngët. “Korabi i mban sytë nga deti, - shprehet në fund të analizës. “Pranveratshkojnë e vijnë, malli djeg gjirin e nënave, retë e zeza zënë diellin e pranvera mbush bjeshkët më bar e lule, me kingja të njomë e dele rudë... një fyell diku bie për të qetësuar Hatixhen e bukur..”. Ndoshta ia vlejnë të përsëriten disa shprehje. Naimi është poet...

Dhe duhet të gjurmohet, qoftë edhe në përsëritje. Jemi në kohën e përgatitjes për Festivalin Mbarëkombëtar Folklorik të 2008-ës. Është dhe dyzetvjetori nga Festivali i parë. Dibra ka shumë forca artistike, midis të tjerëve Naim Plakun. Është rasti për të thënë se, nëse deri vonë ishte në hije, tashmë Dibra e ka dhe botues. Mendimi i tij, krijimet e tij dhe ndihma e tij nuk duhet të mungojë.

**Autori i këtij shkrimi punon në Qendrën Kombëtare të Folklorit*

Profesor Ibrahim Egriu, njeriu që e ngriti lart emrin e Dibrës dhe në vendet skandinave

(Vijon nga faqja 9)

Fjala e tij pritet me nderim e respekt të veçantë. Pjesëmarrësit mendojnë se është koha për një Institut Shqiptar të Studimeve Gjeostrategjike. Ishin pikërisht këto delegatë, përfaqësues të rreth 15 milion shqiptarëve kudo në botë, që duket po rizgjohen nga koma. Në krah të profesor Egriut e shoqja e tij Mensure, një grua akoma simpatike dhe pse mosha bën të sajën. Një miku im teolog emrin e saj e përktheu si “ndihmëtare”. Vërtet e tillë ka qenë zonja e tij fisnike, duke mbështetur për 40 vjet rresht punën titanike të profesorit. Ata janë bashkë. Kanë dhe katër djem të mrekullueshëm, që punojnë me biznese serioze e të ndershme, duke u përpjekur ta çojnë më tej punën e babait të tyre. Profesori sapo ka mbushur 68 vjeç. Ndër urimet e shumta që i kanë ardhur nga të katër anët e botës do të veçonim atë të Beqir Elshanit: “Ti je një lumë dibran, që kurrë nuk ndalesh dhe fare nuk do t’ia dish për stuhinë dhe rrebeshet. Sa më shumë që ka furtunë, aq më shumë shkruan dhe ti, meqë në zjarr njihet ari dhe në erë valon flamuri kuq e zi. Atje ku ka revoltë, atje je dhe ti. Atje ku ka fitore, atje je dhe ti. Të lumtë dhe dalsh faqebardhë!”

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Guri i poshterkës





Nga **NAIM PLAKU**

Kikja, cuca e mbrame e Ute Llozit, sapo kishte shkelë në senen e ogurit, ishte çelë e zbukuruar dhe vishej pak më ndryshe, kur merrte tufën e shqerrave dhe i podiste mejave të Kollovozit, sapo dielli shkrepte syrin e zjarrtë aty mbi mal. Sesi dukej këtë mëngjes vjeshte, mes atyre livadheve të njomur me lashtën e argjendtë dhe dushkajës përreth me atë mozaik ngjyrash që ta jep vetëm Shmitri: një siluetë e këndshme në sfondin e maleve. Ashtu, e veshur siç visheshin vajzat e asaj kohe, me done të bardha e të qëndisura me tengele anash deri në kërcinj të gjurit, me çorapet breza-breza që lidheshin mbi ta me dy tufa të kuqe, me opinga të reja lëkure e norta të bardha, me një këmishë birinxhije e një jelek cohe mavi që lëshohej sipër një brezi me vija, me atë shaminë e kuqe të lidhur pas koke e dy cepat me tufa që lëshoheshin mbi gjoksin e ngurtë, dukej më shumë si një luftëtare, sesa një bareshë.

Kikja nuk e dinte se vetëm para pak kohësh do të linte një emër të përjetshëm, aty majë malit të thepisur, sipër katundit të saj. Bile, do të linte dy emra që sot e asaj dite ndritin menjëherë sa del dielli, dy emra të lidhur me fijet e një dashurie të brishtë e të pafat.

Por Kikja e kuptonte se po rritej. Çdo ditë merrte me vete harxhet dhe ulej e qëndiste, thurte çorape, gajtane e punore të tjera vajzash. Atë ditë kishte në dorë poshterkën që nëna ia kishte endur në razbonj dimrin që shkoi dhe tani po i qëndiste ca lule në qoshe me penj leshi plot ngjyra. Tek kjo lëndinë e rrethuar me drunj dushku e çonin këmbët çdo ditë, pa e kuptuar. Diçka kishte filluar të lëvizte brenda saj. Një melodi e ëmbël fyelli vinte nga larg dhe i hynte drejt e në zemër. Pastaj një jehonë e përzier me fishkëllima përplasej shpat më shpat:

-Kuuuu –jeeee –Kiiii-keee?

Një djalë i qe shfaqur disa ditë më parë paksa përtej Delujzës, përroit që ndante dy katundet, i kishte dërguar ca reflekse drite mbi fytyrën e vajzës me copën e gurtë që kishte marrë tek Përroi i Pasqyrës dhe Kikja kishte buzëqeshur. Pastaj djali kishte grish dashurinë me një melodi të re, që kishte mbledhur rreth vetes gjithë zogjtë e pyllit. Kështu dashuroheshin të rinjtë aso kohe. Kështu shpreheshin: me tinguj, me jehona, me rreze drite…

Katundi i Lekës ishte nja nëntë tërkuzë larg atij të Kikes, katunde vëllezër siç i thonë. Leka ishte trim. Martina kishte nisur t'i këndojë pa i kënduar ende zokthi. Me shkjaun e vjetër ishte përgjak disa herë, kur i ati, Dika, e merrte me vete për t'i mësuar mejdan. Kur Dika i pat thënë një ditë se tani kishte ardhur koha për t'u lidhur kunjit, Leka i pat thënë:

- Një vrap breshke e kam nusen, or babë, por kur mori vesht se ajo ishte Kikja e Ute Llozit, qe ndalur fort:

- Nuk bën, o Lekë! Utja me atë Kiken që don ti, i mori shkjatë nga Maja e Bardhë e i solli në kishën e Shtodrit. Vërtet ishin të plagosur e për t'u qarë hallin, por gjarpri, edhe i ngrirë po të jetë, në gji nuk futet.

- Nuk bahet luftë me vorre, babë, - iu përgjigj Leka, - mirë ka ba.

- Jemi zanë keq. Ia vrava të dy mu aty në oborr të kishës dhe bëri atë që se bën burri. Më ktheu pushkën dhe desh u vramë. Uta mik me mua nuk bëhet kurrë.

- Kiken, vetëm Kiken do të marr nuse, o babë. Kështu qe zemëruar edhe Uta kur mori vesh se e bija donte djalin e Dik Lekës.

- Hiqe nga mendja, i kishte thënë së bijës. E shikon atë majë, aty do të ta këpus kokën. Po, po, tek ai lisi mbi majë do të të var me dorën time po more birin e Dikës.

- Lekën, vetëm Lekën. Për atë jam rritun kaq, atë do të marr, - thoshte e vendosur Kikja. Punët po trasheshin shumë e më shumë. As Dika e as Uta nuk lëviznin gjurmët. Kau për brirësh e burri për fjalësh mbahen. Pastaj ujët nuk bëhet kos kurrë. Por Leka me Kiken takoheshin, shiheshin, flisnin me trokëllima, me shigjeta drite pasqyrash, me melodi fyelli e kënge. Kikja vazhdonte të qëndiste poshterkën nën hijen e lisave dhe Leka kalonte sa në një majë mali në tjetrën dhe nxirrte rrallë e tek ndonjë krismë martine. Erdhi një ditë fort e keqe. Uta këputi fjalë dhe ndau shpejt e shpejt orok me Dil Kepin dhe deshi ta martonte Kiken me djalin e tij. Kikja ia nisi vajit. Leka i ngjante një bishe të tërbuar që po i merrnin gjahun. Kush do të ishte ai burrë që do t'i merrte atij Kiken?

Vjeshta e tretë po vinte me të ftohtë. Kikja kishte dalë fshehurazi nga shtëpia, kishte marrë poshterkën dhe bënte sikur po qëndiste tek ai lisi ku rrinte zakonisht. Pika lotësh binin mbi lulet e kuqe dhe ofshama rritej e rritej, kur ia befi Leka:

- Kike, je gruaja ime që sot! - dhe i rrëmbeu nga prehri poshterkën me ato dy lulet e lagura me lot, ende të pambaruara. U ngritën të dy me duar të lidhura, si dy pisha brenda humnerës, duke vështruar nga qielli. Një krismë e thatë rrufeje shkëputi dy duar. Një jehonë e fuqishme u përhap shpat më shpat:

- Kikeeee! Je e imja, ihooo!

- Pooo, Lekë, poooo…

Kikja hyri në kullë afër mbrëmjes. Dhentë ishin futur në vathë e qentë këtë natë po lehnin si shumë. U afrua tek nëna e saj, e shmangu diku dhe i tha më zë të dridhur:

- Thuaj babës se jam nuse gjaku, se…

- Si?! - lëshoi një britmë duke lëvarë faqet nëna.

– Po, po. Leka ma rrëmbeu poshterkën. Shtëpia u ndez. Uta vinte rrotull e përpëlitej si zorra në prush. I vërsulej të bijës e të ëmës, djemve, vetes:

- Mbylleni mecën! Na futi në gjak! Rrëmbeu pushkën nga kunji dhe e mbushi mirë. Na e mbylli derën me marre. Fjala aso kohe ecte shpejt dhe brenda natës mbërriti te Dil Kepi, i cili ashtu i qetë, siç tregohej zakonisht, lëshoi një fjalë që e përtypi ca:

- E, po, ka dhe burra që hyjnë në vathë të huaj. Leka mbështolli poshterkën nën kuparanen e tij dhe si veriu mori vrapin. Kaloi Kollovozin, përroin e Shëngjergjit, kapërcei Delujzën dhe u ndal matanë një kodre, ku është një gur i madh me një strehë rrase të gjerë. Aty brenda një guve të vogël fshehu poshterkën e Kikes me kujdesin ma të madh. Kur shkoi në shtëpi, ashtu i lodhur siç ishte, i tha Dikës:

- Ta solla një bela në shtëpi, o babë!

- Fol, Lekë, se diçka më ziente!

- Ia mora një nishan Kikes…

Dita e dasmës së Kikes me djalin e Dil Kepit po afrohej. Gjakrat e tri palëve ishin ndezur aq shumë nga thashethemet, sa priteshin zhvillime të paparashikueshme. Ditën e dasmës, Kika u vodh e iku pa ardhur akoma krushqit e hipi lart mbi majën e malit dhe shikonte përtej arës së Lekës, andej nga guri me strehë, ku zemra i thoshte se ndodhet poshterka e saj.

Leka kishte vrapuar e nxjerrë poshterkën nga guva ku e kishte fshehur dhe valëviste me krenari majë kodrës që ta shikonte dhe Kika. Poshtë në katund lodrat bubullonin e po i afroheshin konakut. Një pushkë tinëzare çante përmes shkurreve nga sipër kodrës së Mullezës për të parë gjoksin e Lekës. Nusja Kike qëndronte mu në majë të kodrës, bri humnerës, tamam si një pishë e lartë e gjelbër, që po prek qiellin me dorë. Jehona përplasej maleve:

- Kikeeee, ku jeeee, ku jeee?… Dhe tundte poshterkën. Një plumb e korri nga prapa, u rrëzua si një lis i madh me fytyrë nga Kika. Poshterka me dy lulet e kuqe u rrokullis e ra mbi shkëmbin me rrasa. Nga maja tjetër vinte një zë i fuqishëm:

- O Lekë-ooo, ku jeeee?… Dhe u hodh në greminë për të mos u gjetur kurrë. Dasma vdiq. Krushqit u bënë varre. Vetëm mbetën sot e kësaj dite dy emra, që s'kanë as varr, as vdekje: Kika e Venishtit dhe Guri i Poshterkës.

1) Senen e ogurit - kohën që ndjell fat, mirësi.
2) Lashtën - vesën e mëngjesit.
3) Podis - podita, fol.-em, = përzë, e hedh jashtë diku.
4) Këmishë birinxhije - një lloj këmishe grash, veshje e sipërme me mëndafsh të hollë.
5) Poshterkë-a, at, em,- përparëse prej leshi që endej me një lloj shajaku të hollë dhe zbukurohej me qëndisma anash.
6) Shkjau i vjetër - është fjala për pushtuesit e hershëm sllavë, bullgarët që erdhën në Shqipëri në mesjetën e hershme.
7) Orok-u, em - dita e vendosur nga të dyja palët për dasmë.
8) Lever–levera - gërvisht fytyrën nga një e keqe a zemërim.

Kodoshët e Fjalës

Nga RAMIZ GJINI, New York

Që kur tatëzotin e mençur e la takati, zunë fill prapësitë. Kaq shumë u lig i ngrati sa nuk pati kohë as të linte amanetet e fundit. Vdiq dhe u harrua si të mos ishte. Thonë që para se të mbyllte sytë, nxorri një grahmë dëshpërimisht të motivueshme: nuk kish pasur kujt t'ia linte gjënë më të çmueshme, më të brishtën, më të urtën e më të mirën në botë: ***FJALEN***. Kështu, baca i mençur vdiq e shkoi, u bë fir si të mos ishte. Madje u harrua përfare. Kurse **Fjala**, ajo e brishta, ajo që vriste dhe shëronte sipas rastit e rrethanave, mbeti jetime, qyqare në mes të katër rrugëve të Shqipërisë.

Me ta parë ***Fjalën*** në mes të katër rrugëve, zhganin e kodoshëve na e zuri shili, iu sul asaj turrshëm ta bënte me turp. E thënë troç dhe shqip, të gjithë bashkë, këta kodoshë me sy të kuq, iu sulën që ta shkërdhenin. E shkërdhyen për dyzetë e pesë vjet me radhë, e kafshuan, e kataleshën, e burgosën, madje jo pak herë, e varën edhe në litar.

Andej nga viti nëntëdhjetë u duk se fjala u ngjall dhe po fitonte lirinë, pavarsinë e dinjitetin e nëpërkëmbur, por nuk ndodhi ajo që duhej të ndodhte. Sërish e futën në dorë kodoshët ***Fjalën***, e dhunuan për pesëmbëdhjetë vjet dhe vazhdojnë ta dhunojnë edhe sot e kësaj dite. Ia bëjnë atë punë ditën për diell mu në mes të parlamentit shqiptar, në zyra kancelarishë nëpër botë, në mjedise publike, në organe shtypi, televizione, konferenca, simpoziume, madje edhe nëpër libra. Kudo ku ka sehirxhinj me veshët ngrehur, kudo ku ka lexues të etur për ***Fjalën.***

Ka edhe nga ata burra të mençur, që dhimbsurohen kur shikojnë se në çfarë llumi është zhytur ***Fjala***, por nuk kanë ç'të bëjnë, sepse kodoshët nuk ua japin atyre ***Fjalën***. Përpos kodoshë, ata na janë edhe xhelozë të mëdhenjë, madje gjer në vdekje, ndaj e mbajnë për vete ***Fjalën***. Kështu, që të mençurit nuk kanë ç'të bëjnë. E kanë kyçur gojën. Dhe po t'u kërkosh me insistim, të tregojnë qoftë vetëm njëherë vullnet, që ta marrin ***Fjalën***, thjeshtë për ta fisnikëruar e për t'i rikthyer dinjitetin, atëherë të mençurit i zë idhnimi. Humbin durimin, u kërcejnë rrebet në kokë. "***Fjala*** u bë kurvë e ndyrë", - thonë ata, - Nuk fisnikërohet më. E futi në dorë gjithë brigada e madhe e plehut...

Ngase lista e kodoshëve të ***Fjalës*** është e pafund, të mençurit gufosen, i zë ngërçi, kthejnë shpinën dhe ikin në heshtje. Dhe kanë hak! Sepse të gjithë po e shikojmë se si hidhet e përdridhet ***Fjala*** rreth shtyllës së turpit. Tash ajo nuk e njeh më të vërtetën sublime për nënë, nuk është më bijë e saj, nuk i përket më nderit, por turpit. Është divorcuar me veprimin konstruktiv dhe ka vënë në lëvizje forcën destruktive...

Fjala sot të bën me ***fjalë***. Ajo është vetëm emërtuese dhe përdoret nga kodoshët për të sharë me rroc e koc; për të luftuar kundërshtarët e tyre politikë. Ajo nuk është më e urtë si në kohën e iluminizmit, është e rëndë tash kjo horre e dreqit, e vrazhdë, shkurtabiqe, fyese, madje poshtëruese.

Fjala është privatizuar me forma korruptive, është bërë pronë e partisë, e ministrit, e drejtorit, e biznesmenit, e banditit, e poetucit, e shkarrashkruesit. ***Fjala*** nuk ka më burrë si ai i Motit të Madh, por ka burrecë. Ajo sot është poliadrike. Ka vetëm kodoshë që e mbajnë për dashnore, e pështyjnë, pastaj e lëpijnë dhe e gëlltitin pa e përtypur fare. Ajo mbarset çdo ditë prej kodoshëve të saj dhe pjell kurvicka të vogla. Ka bjerrur peshën dhe masën, kuptimin, fizionominë; ka bjerrur autonominë dhe respektin. ***Fjala*** sot shkëmbehet, tirret, rrëmbehet, ntrashet, shitet e blihet për pesë qindarka në pazarin e rregxinave. Por, ***Fjala*** kushton edhe miliona dollarë në raste të veçanta. Me ***fjalën*** - prostitutë, në Shqipëri po bëhet pare e madhe. Ajo sot është punëthartë për mua dhe për ty, i dashur lexues, që s'jemi kodoshë të ***Fjalës***. Pikërisht për shkak të këtyre të këqiave, të mençurit nuk duan ta qasin ***Fjalën***.

Shikojini kodoshët e ***Fjalës*** ç'poza që marrin në karriget e tyre të pushtetit, në konferenca shtypi, para kamerave! Kapardisen si qentë e zgjebosur në majë të qerres së pushtet- shtetit. Në sediljet e makinave të shtrenjta, prapa xhamave të errët, parakalon dhe përshëndet me dorë gjithë falsiteti, fryrja dhe krekosja e kodoshëve të ***fjalës***! Të kollarisur e të krehur me kujdes, këta ashikë të përvëluar të ***Fjalës***, kanë vënë në fytyrë maskën e politikanit, atdhetarit, heroit kombëtar, demokratit, socialistit modern, luftëtarit të korrupsionit, hartuesit dhe mbrojtësit të ligjit, oratorit, shkencëtarit, dijetarit, poetit e shkrimtarit. Detyrimisht e me çdo çmim, të gjithë këta shpirtëkëllirë e pafllatarë, duan të jenë me çdo kusht zotër të ***fjalës***.

Kodoshët e ***fjalës*** nuk mungojnë edhe në letërsi, në akademitë përkujtimore, në promovime librash - paçavure, në takime e tubime. Të gjithë vijnë vetëm për të folur. Ata flasin që të dëgjojnë folësit e tjerë dhe jo dëgjuesit, sepse dëgjues, siç thamë nuk gjendet asnjë për be. Në jetën e tyre të shkurtër, këta kodoshë të ***fjalës***, kanë jetëgjatësinë e kërpudhës. Ata vegjetojnë vetëm në shi e në mjegull. Feksi i rrezeve të diellit i verbon. Sapo të zërë të rigojë një shi i imët, sapo mbi tokë të shtrihet mjegulla me trajtat e saj amorfe, kodoshët i harrojnë stërgjyshërit e tyre vorbëtarë. I turren ***Fjalës*** vend e pa vend, radhë e pa radhë, thjeshtë se u pëlqen ta mbarsin ***Fjalën***. Në ritin e tyre të përditshëm, nuk respektojnë asnjë rregull a normë. Shtyhen bërrylash, rrihen me grushte, i fryjnë bilbilit, torolingës, zamares, i bien tupanit, tollombazit, ia marrin njëri-tjetrit fjalën nga goja, thjeshtë pse janë tmerrësisht xhelozë për ***fjalën***, thjeshtë pse e duan gjer në vdekje ***fjalën***. Kaq shumë i zë shili, sa, nganjëherë, në kapërthim e sipër, në vend që t'ia fusin ***Fjalës***, ia fusin njëri-tjetrit.

Kodoshët tanë të ***fjalës***, po e shesin Shqipërinë, po ia lidhin qerres së armikut për trofe. Dhe janë pikërishtë vorbëtarët, shollarët e teneqepunuesit e traktorit të parë shqiptarë, që po e kthejnë Shqipërinë në një vend kotësishë, pervesitetesh, orgjishë kutërbuese, që aman o Zot!

Kurse ***Fjala***, ajo që më parë të magjepste me një ngarkesë sublime mendimi e ndjenje, ajo që të ngrohte, që të mbushte me gazmend, me krenari e dinjitet, tash bie erë tradhëti, perversitet, plehurinë, vezë e prishur, xhiris. Sa keq që u katandis ***Fjala***. Sa keq që e mori ferra ***Fjalën***.

Në përmbyllje mu shti në kujtesë një thirrje e shkrimtarit Martin Camaj: *Leni more të rrjedhin prej gjuhëve tona vetëm **fjalë** të përflakta, **fjalë** që me përshkue detin tej për tej e me ça gurin si me kepa çeliku. Çoje, bre, zanin deri në kup të qiejve e të na marrë vesh Ai që vran e kthjell në çdo skutë qiellore.*

Prezantohet libri "Rruga e Arbërit"

Në një nga mjediset e Hotel Tirana, më datë 8 shtator, u promovua libri "Rruga e Arbërit", botim i Shtëpisë Botuese "Bota Shqiptare, me autor Faruk Kaba.

Në promovim, i organizuar nga Shoqata e Inxhinierëve Konsulentë, merrnin pjesë inxhinierë e projektues të rrugëve në vend, deputetë, ish-ministri i Transporteve, etj.

Diskutantët në këtë takim rivunë në vëmendje se ndërtimi i Rrugës së Arbërit është një nevojë jetike për vendin. Ing. Faruk Kaba, Doktor i Shkencave, bëri një përshkrim të shkurtër të Rrugës së Arbërit.

Më pas, të pranishmit që morën fjalën vunë në dukje disa elementë që do të bëjnë të mundur fillimin e punës, që Rruga e Arbërit të ndërtohet sa më parë.

Deputeti Sali Shehu ritheksoi angazhimin e qeverisë shqiptare për ta ndërtuar Rrugën e Arbërit jo vetëm si një angazhim i qeverisë, por edhe si nevojë e gjithë komunitetit dibran e më gjerë, që rruga të funksionojë një ditë e më parë. Ai falënderoi personalisht ish-ministrin e Transporteve, z. Spartak Poçi, i cili, padyshim, ka një kontribut në këtë drejtim.

Z. Sazan Guri, një nga aktivistët e lëvizjeve mjedisore në vend, i cili i ndjek vazhdimisht aktivitetet për Rrugën e Arbërit, theksoi në këtë takim se komuniteti dibran duhet të gjejë mekanizmat financiarë për hartimin e projektit teknik. Pas kësaj, - tha ai, - mund të jetë më e lehtë për gjetjen e financimeve për fillimin e punimeve. "Sheikë dhe banka ka sa të duash, por ne duhet të kemi më parë dëshirën për të punuar".

- "Unë ka kohë që nuk kam qenë në Dibër, tha aktori e regjisori i njohur dibran, Bujar Kapexhiu, i pranishëm në këtë takim, por me Rrugën e Arbërit unë do të shkoj më shpesh atje".

Autori Faruk Kaba, i cili ka drejtuar grupin e Studimit të Fisibilitetit për Rrugën e Arbërit ka përfshirë në këtë libër një pasqyrë të shkurtër të Studimit, si dhe disa shkrime në mediat e ndryshme lidhur me këtë aks.



Pjesë nga libri:

... Së fundi, në planin e shtetit për vitin 2007, është parashikuar edhe një Studim Fisibiliteti i "Rrugës së Arbërit", tashmë nga Tirana në Bulqizë. Për më shumë janë vënë në dispozicion 30 milionë lekë. Kur Rruga e Arbërit ka një studim fisibiliteti, të miratuar edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Këshilli Kombëtar i Rrugëve, nuk e kuptojmë përse bëhet kjo. Dikush në DP të Rrugëve, na tha se ka dyshime, që rruga mund të kalojë atje ku ajo është trasuar. Këto janë vërtet çudira. Por, ose i thotë dikush, që nuk merr vesh nga këto punë, se këtu ka diçka tjetër, pasi ai që ka bërë studimin e Fisibiliettit dhe ka demonstruar kalimin në drejtimin tashmë të detajuar, sigurisht që merr përsipër që të bëjë dhe projekt zbatimin e kësaj rruge, përfshi edhe veprat e saj ura apo tunele. Se si është e vërteta, le të shpresojmë ta mësojmë sa më parë. Dhëntë zoti që të mos ketë një padrejtësi tjetër si ajo me të "Drejtat e Autorit" dhe në Shqipëri të fillojnë të respektohen standardet dhe rregullat nga zyrtarët.

Faruk Kaba, "Rruga e Arbërit", Fq. 13

NJOFTIM

Me rastin e botimit të edicionit të ri të kalendarit "Dibra 2008", ftojmë fotografë profesionistë dhe amatorë të marrin pjesë në konkursin e hapur me këtë rast më fotografi nga vende të ndryshme të Dibrës. Fotografitë do të përzgjidhen nga një juri fotografësh, dhe fotot që do botohen do të shpërblehen.

PËR KONTAKT: *Tel:* 069 20 68 603.
E-mail: mbbotime@ gmail.com; djmenny@gmail.com



"Dibrës i ka pikur vathi, por jo veshi!"

Nga GAZMEND KËRKUTI

Liqenet e Lurës kanë qenë gjithmonë një ëndërr e imja personale t'i shikoja nga afër… Kjo ëndërr m'u plotësua këtë vit, gjatë pushimeve në Dibër.

Liqenet e Lurës ndodhen në Dibër, e cila është zona më e madhe shqiptarë ne zemër të vendit, por politika antishqiptare (ajo e sllavit në radhë të parë) e kanë ndarë... "Bujku në Shqipëri, toka në Dibër" ose "Nëna në Shqipëri e djali në Dibër (Jugosllavi)" - thuhej dikur (edhe sot) për ndarjen padrejtësisht të Dibrës në dy anët e kufijve…

Por edhe sot vazhdon kjo ndarje. Shiko lajmet në TV dhe dallohet lehtë se kush po mundohet të bëjë të njëjtën gjë me Kosovën: Rusia!

Të parët tanë kanë pasur plotësisht të drejtë që kanë luftuar për këto troje, sepse kanë ditur se ç'të mbrojnë.

Këtë verë, bashkë me Dukagjinin, një emigrant dibran në Itali dhe disa shokë të tjerë nga Dibra, vizituam Sturmicën, një qytet në pjesën lindore të Maqedonisë… Për disa çaste menduam se jemi në Sahara. "Si nuk morëm pak grurë, - tha Dukagjini, - se këtu pula gurë ha…" Ndërsa në Dibër, krejt ndryshe… Miqtë tanë, që vizitojnë Dibrën, mjafton t'i çosh për një peshk a kafe të Taverna "Cami" dhe mbesin gojëhapur… Mrekullohen nga bukuritë që i rrethojnë…

I shkruaj këto fjalë nga zemra e plasur që kam. Dua ta shikoj këtë vend të begatuar e të zhvilluar dhe për këtë po bëj të pamundurën, që të ngre nivelin e Dibrës në sytë e botës, qoftë edhe 1 %.

Për të folur për politikë "jam një fëmijë", por edhe "fëmija" i kupton ca gjëra… Jam shumë i inatosur me drejtuesit e Universitetit të Tetovës, që as këtë vit nuk hapi një degë të Universitetit në Dibër, kur ishte Dibra ajo që dha votën e para për hapjen e atij Universiteti. Dhe ishin ditë të vështira ato, ku rrezikoheshe të flisje hapur për Universitetin shqiptar të Tetovës.

Jam shumë i inatosur edhe me shtetin shqiptar, që e ka lënë pas dore "Rrugën e Arbërit"…


Jam edhe më shumë i inatosur me njerëzit tanë në Dibër që vjedhin paratë e Dibrës, duke detyruar kështu rininë të ikë dhe të vuajë në mërgim…

"Dibrës i ka pikur vathi, por jo veshi!" - më tha këtë verë një plak në Dibër.


Megjithatë, zhvillimi i Dibrës do të varet nga ajo se sa do të punojmë ne, të gjithë së bashku…

(www.dibra.org)

BOTIMET TË REJA TË AUTORËVE DIBRANË









Naim Berisha
RRËNJËT

Sa pemëve me kokrra u janë prerë rrënjët?
Sa rrënjëve të thella u janë prerë pemët?
Sa mijëra pemë janë thyer më dysh përpara rrënjëve të tyre.
Sa e sa rrënjë, sa e sa pemë nëpër shekuj kanë mbajtur fort me të dyja duart gjinjtë që u lëkundeshin prej frymëmarrjes e dihatjes së shpeshtë.
Gjithsesi, të gjitha llojet e rrënjëve, të zbardhura a ë pazbardhura, janë ende më të hershme, ende, me një fjalë, me të vjetrën.
Si toka me rrënjët, njerëzit me brengën

Marrë nga libri "Nata e një lypësi"

Grafika: ***Studio "m&b"****. Tel: (04)* ***233 283****. Shtypur në shtypshkronjën "****Dita 2000****". Tel: (04)* ***273 745***